

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5516
E martë, 3 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Hahni: Kosova nuk është çështja e vetme për përparimin e Serbisë drejt BE-së



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

KOMPROMISET E REJA DO TA ZHBËNIN SHTETIN E KOSOVËS. JA PSE

F. 11

Milazim KRASNIQI



NDARJA TERRITORIALE, ÇMIM FATAL NË BALLKAN

F. 11

Burim RAMADANI



VETËVENDOSJA KËRKON VENDOSJEN E VIJAVE TË KUQE NË DIALOGUN ME SERBINË

F. 7

EKONOMI

BASHKËPUNIMI MES INSTITUCIONEVE VENDORE KRIJON POLITIKA TË MIRËFILLTA EKONOMIKE

F. 9

KULTURË

HAPET EKSPOZITA 'GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË VEPRAT E ARTISTËVE EVROPIANË'

F. 10



SPORT

SHOIPTARËT E ZVICRËS KËRKOJNË ÇEREKFINALEN

F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI ARIFI

FAQE 4-5

Bashkimi i forcave politike në dialogun me Serbinë, i domosdoshëm

Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije se pala serbe nuk po tregon gatishmëri për mbajtjen e takimeve të cilat kanë për qëllim implementimin e marrëveshjeve të arritura. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kanë kërkuar nga BE-ja dhe vendet anëtare të saj t'i bëhet presion Serbisë për implementimin e marrëveshjeve por, sipas Arifit, të gjitha kërkesat kanë hasur në veshë të shurdhër. Ai ka vlerësuar se një bashkimi i forcave politike të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë është i domosdoshëm. Sipas tij, duhet të gjendet formula e duhur në mes të pozitës dhe opozitës që dialogu të përfundojë sa më shpejt dhe suksesshëm

UDHËHEQËSIT SHTETËRORË KANË PRITUR NË TAKIME DELEGATËT QË KANË MIRATUAR DEKLARATËN KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT TË VITIT 1990

FAQE 7

U premtohet përkrahje delegatëve të 2 Korrikut

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, u ka premtuar mbështetje delegatëve që kanë miratuar Deklaratën

Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990. Pas takimit që ka pasur të hënën me disa prej delegatëve, Haradinaj ka thënë



se Qeveria do ta përkrahë iniciativën ligjore e cila parasheh rregullimin e statusit të këtyre delegatëve



IU DHA LAMTUMIRA E FUNDIT VEPRIMTARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE, BAJRUSH BEHRAMI

Behrami u përket emrave që jetojnë edhe pas vdekjes

Në varrezat e qytetit të Besianës të hënën i është dhënë lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare, Bajrush Behrami, ku

ishin të pranishëm zyrtarë të institucioneve të Kosovës, përfaqësues lokalë, përfaqësues të organizatave të luftës së UÇK-së dhe qytetarë të shumtë

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi telefonon Mitchellin, bisedon për ecurinë e dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka zhvilluar të hënën një bisedë telefonike me ndihmësekretarin e Shtetit të ShBA-së për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Wess Mitchell, me të cilin ka bashkëbiseduar për forcimin e marrëdhënieve bilaterale dhe për fazën e fundit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ne u pajtuam për shtimin e dialogut dhe domosdoshmërinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare, ligjërisht obliguese me Serbinë.

Dialogu dhe marrëveshja përfundimtare janë mënyrë e vetme për t'u hapur rrugë integritimeve euroatlantike për Kosovën dhe për ta siguruar paqen dhe stabilitetin afatgjatë në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Thaçi.

Presidenti ka bërë me dije se Kosova, si gjithmonë, gëzon mbështetjen e palëkundur amerikane edhe në fazën e fundit përfundimtare të këtij procesi të vështirë, por jo të pamundur për t'u përmbyllur me marrëveshje.



Hahn: Kosova nuk është çështja e vetme për përparimin e Serbisë drejt BE-së

Pas takimit që pati të hënën në Beograd me presidentin e Serbisë, komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, i ka porositur autoritetet e Serbisë se normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën nuk është çështja e vetme për përparimin e Serbisë në rrugën e integritimit në BE

BEOGRAD, 2 KORRIK - Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, i ka porositur autoritetet e Serbisë se normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën nuk është çështja e vetme për përparimin e Serbisë në rrugën e integritimit në BE. Hahn, duke folur pas takimit me presidentin serb, Aleksandar Vuçiq, në Beograd, ka thënë se

Kosova është çështje e rëndësishme, por jo e vetmja. "Është e qartë se kjo është një çështje aktuale, por nuk është vetëm ajo e rëndësishme për përparimin e Serbisë në rrugën e eurointegritimit. Ka edhe elemente të tjera që janë të rëndësishme. Sundimi i ligjit është në zemër të negociatave me BE-në", ka thënë Hahn, duke shtuar se sundimi i



ligjit është faktor i cili përcakton shpejtësinë e procesit të anëtarësimit në BE. "Gjithashtu, është e rëndësishme që Serbia të jetë më tërheqëse për investitorët e huaj. Cilësia e gjyqësorit siguron besim shtesë dhe mendoj se është në interes të qyte-

tarëve", ka deklaruar Hahn. Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e Beogradit me Prishtinën, Vuçiqi ka theksuar se nuk është optimist për rezultatin e dialogut Beograd - Prishtinë në Bruksel sepse, siç tha ai, "shumëçka nuk varet nga

Serbia". Megjithatë, Vuçiqi ka pohuar se këto bisedime duhet të vazhdojnë për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin e gjithë rajonit dhe se Serbia është gati për kompromis. "Shteti ynë është një prej faktorëve që dëshiron ta ruaj stabilitetin dhe paqen. Nëse është e nevojshme do të diskutojmë tri herë në ditë me Kosovën vetëm për ta ruajtur jetën e serbëve që jetojnë në Kosovë dhe Metohi", është shprehur ai. Sipas Vuçiqit, Beogradi zyrtar aktualisht nuk ka pozicion të lehtë për të bërë kompromis. "Është mirë që pas 10 vjetësh negociata të ketë zgjidhje se sa të ketë luftë", ka deklaruar ai në një konferencë me gazetarë.

Veseli viziton Holandën, do të pritët nga kryetarja e Senatit



PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në vazhden e vizitave të tij nëpër vende të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit për liberalizimin e vizave për Kosovën, ka udhëtuar të hënën për në Holandë. Në një komunikatë të Kuvendit të Kosovës thuhet se gjatë vizitës zyrtare në Holandë, Veseli do të pritët në

takim të posaçëm nga presidentja e Senatit holandez, Ankie Broekers-Knol. Veseli do të diskutojë me homologen holandeze për zhvillimet politike në Kosovë, për perspektivën evropiane dhe do të kërkojë në mënyrë të veçantë mbështetjen e Holandës në procesin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Gjatë vizitës kreu i

Kuvendit të Kosovës do të zhvillojë takime të veçanta edhe me eurodeputetë holandezë, me deputetë të pozitës dhe të opozitës në Holandë, me të cilët do të bisedojë për bashkëpunimin ndër-shtetëror, për reformat e gjithanshme që ka shënuar Kosova dhe të ardhmen e saj evropiane", është theksuar në komunikatën për medie të Kuvendit të Kosovës.

Flecknestein: Shqipëria t'i bëjë detyrat e shtëpisë hap pas hapi

TIANË, 2 KORRIK - Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein, po qëndron për vizitë në Tiranë. Ai mori pjesë të hënën në një

aktivitet ku temë ishte anëtarësimi i Shqipërisë në BE, pas konkluzioneve të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian. Në aktivitet ishte i

pranishëm edhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, dhe ambasadorja e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Romana Vlahutin. Ministri Ditmir

Bushati ka deklaruar se një vit kohë do të jetë i mjaftueshëm për punën përgatitore të Shqipërisë, që më pas të nisin zyrtarisht negociatat me BE-në.



Udhëheqësit shtetërorë kanë pritur në takime delegatët që kanë miratuar Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990

U premtohet përkrahje delegatëve të 2 Korrikut



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, u ka premtuar mbështetje delegatëve që kanë miratuar Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990. Pas takimit që ka pasur të hënën me disa nga delegatët, Haradinaj ka thënë se Qeveria do ta përkrahë iniciativën ligjore e cila parasheh rregullimin e statusit të këtyre delegatëve

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 KORRIK - Në 28-vjetorin e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë takuar të hënën ndaras një delegacion të delegatëve që e kanë miratuar këtë deklaratë. Liderët institucionalë kanë vlerësuar lart veprimin e delegatëve të 2 Korrikut, duke thënë se ajo deklaratë ka vënë bazat e pavarësisë së Kosovës. Në një konferencë për medie, pas takimit me delegatët, kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria do ta përkrahë iniciativën ligjore, e cila do ta rregullonte statusin e deputetëve të vitit 1990. "Ka një kosto modeste. Nuk është ngarkesë financiare,

por është më shumë një nder që i bëhet kësaj kategorie", ka thënë Haradinaj.

Ai ka deklaruar se këta delegatë janë e vërteta e rrugëtimit të Kosovës drejt pavarësisë. "Ju jeni historia e gjallë, e vërteta e rrugëtimit tonë. Deklarata e 2 Korrikut, shpallja e vizionit tonë për mëvetësi të asaj kohe ka qenë akt i çmuar, akt themel, nga i cili ka pasuar konfirmimi me Kushtetutën e Kaçanikut dhe përpjekjet e vazhdueshme të rezistencës të mëtejme politike e paqësore, deri tek ajo luftarake për të ardhur te 17 shkurti 2008", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, në kohë mjaft të vështira delegatët e atëhershëm të Kuvendit kanë treguar guxim dhe vendosmëri për shpalljen e Deklaratës Kushtetuese, duke theksuar se

delegatët e asaj kohe janë nderi i Kosovës. "Për nder të 2 Korrikut, Deklaratës që i vuri bazë veprimeve të mëtejshme, Kushtetutës së Kaçanikut dhe vendimeve për të qenë Kosova e pavarur, pata nderin të pres delegatët e gjallë, historinë e gjallë të Kosovës dhe të bashkëbisedojë me ta për temat që na shqetësojnë sot në vend", është shprehur Haradinaj.

Kurse kryetari i atëhershëm i Kuvendit, Iljaz Ramajli, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për kujdesin e treguar dhe ftesën për ta shënuar 28-vjetorin e 2 Korrikut. "Ju keni treguar kujdes të veçantë edhe në kohën kur nuk keni qenë kryeministër për këtë përbërje dhe kjo që ju sot na ftuat është nder i veçantë për ne", ka thënë Ramajli, duke treguar se në takim me kreun e Qeverisë kanë parashtruar disa çështje që janë me interes për delegatët, e që ka të bëjë me mbështetjen materiale të tyre.

Grupin e delegatëve të 2 Korrikut e ka pritur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, duke i uruar për këtë ditë të rëndësishme, ndërsa ka çmuar lart kon-

tributin e tyre në kohë dhe rrethana të vështira. "Akti juaj madhor u parapriu proceseve të tjera të rëndësishme në vitet në vijim: rezistencës paqësore dhe luftës së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kulmoi me çlirimin e Kosovës dhe vite më vonë me shpalljen e pavarësisë së saj", ka deklaruar Veseli.

Derisa udhëheqësi i delegacionit të delegatëve, Iljaz Ramajli, ka falënderuar kryeparlamentarin Veseli për pritjen tashmë tradicionale për ish-ligjvënësit e Kosovës.

Edhe presidenti Hashim Thaçi ka kujtuar 28-vjetorin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, e cila ishte një akt konstitucional për realizimin e aspiratave të popullit tonë për shtetësinë e Kosovës. "Delegatët e Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, me guxim, maturi dhe pjekuri politike e artikulan vullnetin e qytetarëve, i cili çoi drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Pas shumë zhvillimeve historike, Kosova më në fund realizoi projekte të mëdha politike: çlirimin, tranzicionin dhe pavarësinë", ka shkruar presidenti Thaçi në lloga-

rinë e vet në "Facebook".

Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka përkujtuar këtë ngjarje historike. "28 vjet më parë delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës, në shtetëritim nga forca të mëdha policore e ushtarake serbe, miratuan Deklaratën Kushtetuese të Pavarësisë së Kosovës, e njohur si Deklarata e 2 Korrikut. Deklarata e 2 Korrikut e vitit 1990 shënon kthesën e madhe në përpjekjet e Kosovës për liri, pavarësi dhe demokraci", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se me shpalljen e kësaj deklaratë delegatët i kanë dhënë formë dhe përmbajtje për herë të parë Republikës së Kosovës. "Delegatët u mblodhën jashtë dyerve të Kuvendit, sepse nuk lejoheshin të hynin aty, në kushtet e represionit të pushtetit të Serbisë. Me shpalljen e Deklaratës Kushtetuese ata i dhanë formë e përmbajtje për herë të parë Republikës së Kosovës, si një republikë për rezistencë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Procedohet për në Kuvend Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte Inovacion dhe Ndërmarrësi ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, të kryesuar nga Ismajl Kurteshi, kryetar, në të cilën ka shqyrtuar dhe proceduar Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, si dhe ka diskutuar lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të viteve 1990/91 deri në 1998/99.

Në takim komisioni të ftuar kishte përfaqësues të Ministrisë së



Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë

së Financave, Sindikatës të Arsimit, për të diskutuar lidhur me sugjerimet dhe vërejtjet e ministrive

përkatese që kanë marrë pjesë në amendamentimin e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të viteve 1990/91 deri në 1998/99.

Përfaqësuesi i MMPS-së, Bahri Xhaferi, gjatë fjalës së tij tha se ministria që ai përfaqëson, nuk ka qenë sponsorizuese e këtij projektligji dhe, sipas tij, përmbajtja ka mangësi të theksuara. Ai bëri thirrje që ky projektligj të shqyrtohet edhe njëherë.

Përfaqësuesi i Sindikatës së Arsimit, Rrahman Jasharaj, u

shpreh i indinjuar lidhur me kthimin e shqyrtimit të këtij projektligji për herë të dytë. Ai tha se ky projektligj është duke lëvizur që sa vite dhe nuk arrihet asgjë përfundimtare.

Anëtarët e komisionit u pajtuan ta vazhdojnë shqyrtimin e Projektligjit dhe të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet t'i marrin me shkrim nga ministrinë e linjave.

Në vijim të mbledhjes, komisioni e procedoi për në Kuvend Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Flet për "Epokën e re", Avni Arifi

Bashkimi i forcave politike në dial



Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije se pala serbe nuk po tregon gatishmëri për mbajtjen e takimeve të cilat kanë për qëllim implementimin e marrëveshjeve të arritura. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kanë kërkuar nga BE-ja dhe vendet anëtare të saj t'i bëhet presion Serbisë për implementimin e marrëveshjeve por, sipas Arifit, të gjitha kërkesat kanë hasur në veshë të shurdhër. Ai ka vlerësuar se një bashkim i forcave politike të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë është i domosdoshëm. Sipas tij, duhet të gjendet formula e duhur në mes të pozitës dhe opozitës që dialogu të përfundojë sa më shpejt dhe në mënyrë të suksesshme

duhet të gjendet formula e duhur në mes të pozitës dhe opozitës që dialogu të përfundojë sa më shpejt dhe në mënyrë të suksesshme. Kurse sa i përket formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Arifi ka thënë se nuk ka vonesa në këtë drejtim, por se është një proces më i komplikuar. "Nëse ekipi menaxherial ka draftuar një statut që është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës atëherë është çështje jave derisa të fillojë implementimi i tij. Nëse jo, atëherë do të kemi telashe sepse mund të përsëritet situata e vitit 2015, ku në 22 raste kishte shkelje kushtetuese dhe në raste të tilla gjithçka kthehet në pikën zero", ka deklaruar Arifi, duke shtuar askush nuk ka të drejtë të dalë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe

askush nuk ka mandat të nënshkruajë diçka që është në kundërshtim me Kushtetutën.

"Epoka e re": Z. Arifi, kur pritet të zhvillohet takimi i radhës në nivel të dialogut teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë? Cilat pritet të jenë temat e diskutimit?

Arifi: Takimi i fundit trelateral është mbajtur në fund të marsit dhe që nga atëherë, me gjithë insistimin tonë, nuk ka ndodhur një takim i ri për ta diskutuar implementimin e marrëveshjeve të mbetura. Jemi duke insistuar që të ketë takim sa më shpejt, si dhe po kërkojmë nga pala serbe implementimin e marrëveshjes për energjinë, marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve, marrëveshjes për njohjen e diplomave dhe marrëveshjes për hapjen e urës së Ibrit.

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, të hënën ka bërë me dije se janë në pritje të takimeve të reja në Bruksel, në të cilat do të diskutohet për implementimin e marrëveshjes

për energjinë, marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve, marrëveshjes për njohjen e diplomave dhe marrëveshjes për hapjen e urës së Ibrit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se pala serbe nuk po shpreh gatishmëri për mbajtjen e këtyre takimeve. Arifi ka thënë

se kanë kërkuar nga BE-ja dhe vendet anëtare të saj që t'i bëhet presion Serbisë për implementimin e marrëveshjeve por, sipas tij, kërkesat kanë hasur në veshë të shurdhër. Ai ka vlerësuar se një bashkim i forcave politike të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë është më së i domosdoshëm. Sipas Arifit,

ogun me Serbinë, i domosdoshëm



"Epoka e re": Moscaktimi i një takimi të ri po ndodh për shkak të pushimeve apo për shkak të mosgatishmërisë së palës serbe për të dialoguar?

Arifi: Nëse nuk do të ketë takim nuk besoj se do të jetë për shkak të pushimeve, por për shkak se pala serbe nuk po tregon gatishmëri për mbajtjen e takimeve. Megjithatë, takimet duhet të vazhdojnë në mënyrë që sa më shpejt të gjitha marrëveshjet të implementohen.

"Epoka e re": Meqë Serbia nuk po zbaton marrëveshjen e energjisë, atë menaxhimin të integruar të kufijve, po bën pengesa për hapjen e urës, nuk po i nje diplomat si dhe po pengon lirinë e lëvizjes, keni kërkuar nga BE-ja si palë ndërmjetësuese të bëjë më shumë presion mbi palën serbe

për t'i zbatuar këto marrëveshje?

Arifi: Kemi kërkuar dhe vazhdojmë të kërkojmë nga BE-ja që të caktohet një takim i ri. Në mënyrë permanente jemi duke kërkuar nga BE-ja dhe nga vendet anëtare siç është Gjermania, që ta ndihmojë procesin e implementimit të marrëveshjeve por, fatkeqësisht, të gjitha kërkesat kanë hasur në veshë të shurdhër dhe deri më tani nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim. Ne insistojmë dhe po i shfrytëzojmë të gjitha kanalet e mundshme diplomatike për të arritur deri tek implementimi i marrëveshjeve.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh sjelljet destruktive të Serbisë, ka rrezik që dialogu të kthehet në pikën zero?

Arifi: Një dialog i cili nuk prodhon rezultate veçse është në

pikën zero. Në dialog duhet të punohet vazhdimisht dhe duhet të ekzistojë gatishmëria që të implementohen marrëveshjet, posaçërisht implementimi i të cilave varet nga akti jo nga procesi. Për shembull, veprimi për implementimin e marrëveshjes për energjinë nuk është proces, por është akt. Mjafton një takim tri orë dhe ajo implementohet. Ka shumë veprime të cilat kanë mbetur peng i vullnetit politik të palës serbe. Mosimplementimi i marrëveshjeve nga pala serbe po ndikon që procesi i dialogut ta humbë kredibilitetin.

"Epoka e re": Ia vlen të insistohet në vazhdimin e këtij dialogu që nuk po jep rezultate?

Arifi: Dialogu nuk ka alternativë. Më mirë është të diskutohet me

vite sesa të mos diskutohet fare. Jemi qeveri relativisht e re në pushtet dhe si subjekte politike nuk kemi besuar shumë në këtë proces, madje patëm insistuar që ky proces të përfundojë sa më shpejt meqë efektet kanë qenë të vogla. Patëm kërkuar që procesi të ndërpritet dhe të fillojë një proces tjetër, megjithatë në momentumin në të cilin gjendemi insistojmë të implementohen marrëveshjet ekzistuese dhe tek pastaj mund të flitet për tema të reja. Në formën siç ka filluar procesi është me rëndësi të përfundojnë marrëveshjet ekzistuese, pastaj të bisedojmë për tema të tjera.

"Epoka e re": Do të ketë efekt pozitiv në nivelin teknik nisja e fazës finale të dialogut në mes të presidentëve Thaçi - Vuçiq?

Arifi: Natyrisht dhe kjo është shumë e rëndësishme. Nëse bisedimet në nivel të dy presidentëve shkojnë në drejtim të duhur atëherë do të ketë reflektim edhe në implementimin e marrëveshjeve. Është me rëndësi që dialogu politik ta marrë drejtimin e duhur sepse atëherë është më lehtë që bisedimet teknike të kenë sukses.

"Epoka e re": Z. Arifi, për fazën finale të dialogut po kërkohet arritja e konsensusit në mes të spektrit politik. Sa ka gjasa që të arrihet ky konsensus, dhe si do ta bindni opozitën që të bëhet pjesë e këtij procesi?

Arifi: Një bashkim i forcave politike të Kosovës është më se i domosdoshëm në procesin e dialogut me Serbinë. Duhet të gjendet një formulë e duhur në mes të pozitës dhe opozitës, sepse ka rëndësi të jashtëzakonshme që në këtë proces të jemi të gjithë së bashku dhe dialogu të përfundojë sa më shpejt dhe suksesshëm. Tani është në dorën e institucioneve dhe partive politike ta gjejnë formën më të mirë të organizimit. Edhe në të kaluarën kemi pasur momente më të vështira ku ndasitë në mes të subjekteve politike kanë qenë edhe më të theksuara, megjithatë është arritur të gjendet një rrugë për t'i evituar ndasitë dhe për të dalë të bashkuar si palë negociuese.

"Epoka e re": Pavarësisht prej mospërfshirjes së opozitës, procesi i dialogut do të vazhdojë?

Arifi: Dialogu nuk ka alternativë pavarësisht se si organizohet. Në mes të dy vendeve, kur nuk ka dialog, ka telashe dhe ne nuk jemi të interesuar për telashe, por për një dialog në të cilin ka shumë tema për të diskutuar dhe shumë probleme për t'u

zgjidhur. Është interes i Kosovës dhe qytetarëve të saj që ky dialog të rivendoset dhe duhet të punojmë për arritjen e një konsensusi të brendshëm dhe formës së operimit brendapërbrenda këtij konsensusi për të negociuar me palën serbe.

"Epoka e re": Opozita nuk dëshiron që presidenti Thaçi t'i prijë këtij procesi. Ka hapësirë për arritjen e një konsensusi për gjetjen e një emri tjetër për t'i udhëhequr bisedimet, apo do të jetë i pamundur zëvendësimi i Thaçit?

Arifi: Nuk besoj se jam personi adekuat për t'u përgjigjur në këtë pyetje. Legjitimiteti i presidentit buron nga Kushtetua, megjithatë është shumë me rëndësi që ky proces të përkrahët nga Kuvendi dhe Kuvendi të jetë pjesë e tij. U takon deputetëve dhe institucioneve të dalin me një zgjidhje e cila është e pranueshme për të gjitha palët.

"Epoka e re": Çfarë është duke ndodhur me procesin e formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe?

Arifi: Grupi menaxherial ka filluar draftimin e statutit dhe ne ende nuk kemi marrë asnjë draft të këtij statuti, por kemi marrë transkriptimet apo procesverbalet e takimeve që ky grup menaxherial i ka pasur me disa grupe të interesit, mirëpo statut apo draft-statut të Asociacionit nuk kemi marrë.

"Epoka e re": Pse po ka vonesa në këtë drejtim?

Arifi: Është një proces më i komplikuar. Më 8 prill është riaktivizuar grupi menaxherial dhe është çështje kohësh kur ata do të prezantojnë draftin e parë. Nuk ka asnjë ngecje. Arsyeja se a do të ketë ngecje apo jo varet nga ajo se çfarë ka draftuar grupi menaxherial. Nëse ekipi menaxherial ka draftuar një statut që është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës atëherë është çështje jave derisa të fillojë implementimi i tij. Nëse jo, atëherë do të kemi telashe, sepse mund të përsëritet situata e vitit 2015, ku në 22 raste kishte shkelje kushtetuese dhe në raste të tilla gjithçka kthehet në pikën zero.

"Epoka e re": Në asnjë rrethanë nuk do të lejohet që statuti i Asociacionit të jetë në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës?

Arifi: Askush nuk ka të drejtë të dalë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës në këtë proces, si dhe askush nuk ka mandat të nënshkruajë diçka që është në kundërshtim me Kushtetutën.

Thaçi pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri pakistanez

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të hënën letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Pakistanit, Syrus Sajjad Qazi, i

cili sapo është emëruar ambasador jorezident për Kosovën. Presidenti Thaçi i ka uruar ambasadorit të ri pakistanez

suksese në detyrën e re. "Gatishmëria dypalëshe ekziston dhe Kosova e Pakistani mund ta thellojnë bashkëpunimin në shumë

sektorë", është shprehur Thaçi. Edhe ambasadori pakistanez, Syrus Sajjad Qazi, ka konfirmuar dëshirën e tij për ta thelluar bashkëpunimin me Kosovën.



MPB-ja pranon raportin e DASH-it për trafikim të qenieve njerëzore

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pranuar raportin vjetor të Departamentit Amerikan të Shtetit për trafikim të qenieve njerëzore për vitin 2018. Në këtë raport janë theksuar dhjetë rekomandime të cilat u referohen nevojave për rritjen e efikasitetit në parandalimin, luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe kujdesin për viktimat e trafikimit. Sipas raportit të DASH-it, Republika e Kosovës vazhdon të

rangohe në nivelin dy nga tri nivelet themelore. Sipas raportit, Republika e Kosovës ka shënuar progres të dukshëm krahasuar me raportin e vitit të kaluar dhe raportet e tjera paraprake. Ministri Gashi ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht ShBA-në, për përkrahjen e vazhdueshme në fushën e luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore, kurse është zotuar se do të angazhohet për përmbushjen e dhjetë rekomandimeve të dala nga raporti i DASH-it.



MFSK-ja: Berisha nuk ka refuzuar vendimin e Qeverisë për ngritje të pagave

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) përmes një njoftimi për media ka demantuar shkrimet në media, sipas të cilave, ministri Rustem Berisha e ka refuzuar pagën me rritje për të cilën ka vendosur kryeministri Ramush Haradinaj dhe Qeveria në dhjetor

të vitit të shkuar. "Për hir të informimit korrekt dhe objektiv të qytetarëve dhe medieve, informojmë se ministri i FSK-së, z. Rustem Berisha, nuk e ka refuzuar vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave. E vërteta është se nga MFSK-ja, departamenti përkatës, nuk është kryer procedi-

mi për rritjen e pagave për muajin qershor, sipas vendimit të Qeverisë Nr. 4/20 datë 20. 12. 2017, për shkak se procedimi i pagave në MAP dhe MF për MFSK-në është bërë më 8. 6. 2018, kurse vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka dalë më datë 11. 6. 2018. Arsyeja tjetër e mosprocedimit ka qenë edhe

moskomunikimi zyrtar dhe administrativ përmes shkresave zyrtare në mes të MAP-it, MF-së dhe ministrive përkatëse. Kjo procedurë e ngritjes së pagave do të kryhet me efekt retroaktiv sipas datave dhe afateve që parashihet vendimi i Qeverisë", është thënë në njoftimin e MFSK-së.



Kryetari i Komunës së Skenderajt zotohet për vazhdimin e bashkëpunimit me KFOR-in

SKENDERAJ, 2 KORRIK - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të hënën në takim kolonel Daniele Bajata nga KFOR-i italian dhe kolonel Saudan Dominique nga KFOR-i zviceran.

Të dy kolonelët e njoftuan kryetarin Jashari se tash do të bëhet ndërrimi i komandës së JRD-N që deri tani ka qenë duke udhëhequr kolonel Daniele

Bajata, tash e tutje udhëheqës i kësaj komande do të jetë kolonel Saudan Dominique nga Zvicra.

Kolonel Bajata e ka falënderuar kryetarin Jashari për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur gjatë kësaj periudhe, po ashtu kolonel Dominique u shpreh i lumtur që ka ardhur në një komandë e cila ka pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm

me Komunën e Skenderajt, duke shprehur se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për problemet dhe sfidat që përballen qytetarët e Skenderajt. Po ashtu, kryetari Jashari i ka njoftuar përfaqësuesit e KFOR-it edhe për prioritetet zhvillimore të Skenderajt si dhe për zhvillimet e përgjithshme komunale.



Fillon faza e dytë e dezinfektimit selektiv të zonave endemike në Malishevë

Malishevë, 2 korrik - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në koordinim me Shtabin Komunal të Komunës së Malishevës, ka informuar qytetarët e fshatrave për dezinsik-

timin selektiv të zonave endemike në Komunën e Malishevës.

Spërkatja e hapësirave publike do të bëhet, duke filluar nga ora 8:00 deri në orën 12:00.

"Fshatrat të cilët do të përfshihen në dezinfektim, brenda këtyre ditëve dhe datave, janë si në vijim: Balincë, më 3 korrik, Mleqan dhe Pllaqicë e Ulët, më 4 korrik dhe Pllaqicë e Lartë, më

5 korrik. Të gjithë banorët e zonave ku do të bëhet dezinfektimi janë të obliguar t'i marrin masat e duhura preventive", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Malishevës.



Vetëvendosja kërkon vendosjen e vijave të kuqe në dialogun me Serbinë

Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka kundërshtuar rolin prijës të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në dialogun me Serbinë. "Së pari Kuvendi duhet t'i tregojë që ai nuk është njeriu kredibil, i cili nuk mund t'i udhëheqë këto negociata, së dyti të përpilohet një rezolutë nga Kuvendi i Kosovës dhe të vendosen vijat e kuqe edhe për presidentin, edhe për Serbinë, pra që të vendoset një kornizë e interesave të Kosovës jashtë së cilës nuk mund të dalë çdonjëri që mund të shkojë në të ardhmen dhe të negociojë me Serbinë", ka thënë Konjufca



konferencë për shtyp ai tha se me Serbinë nuk kemi vija të kuqe. Tash kur presidenti i hoqi vijat e kuqe, Lëvizja Vetëvendosje mendon se Kuvendi duhet t'ia vendosë vijat e kuqe Hashim Thaçit. Së pari Kuvendi duhet t'i tregojë se ai nuk është njeriu kredibil i cili nuk mund t'i udhëheqë këto negociata, së dyti të përpilohet një rezolutë nga Kuvendi i Kosovës dhe të vendosen vijat e kuqe edhe për presidentin, edhe për Serbinë, pra që të vendoset një kornizë e interesave të Kosovës jashtë së cilës nuk mund të dalë çdonjëri që mund të shkojë në të ardhmen dhe të negociojë me Serbinë", ka thënë Konjufca.

Ai ka folur edhe për vijat e kuqe të kësaj lëvizje në procesin e dialogut. "Prej atyre që Lëvizja Vetëvendosje i mendon si vija të kuqe ndaj Serbisë dhe të cilat do të duhej të ishin të panegociushme, për ato të cilat nuk diskutohet, e para do të duhej të ishte funksionaliteti i Kosovës. Vija e dytë e kuqe do të ishte mospranimi i kurrfarë copëtimi të Kosovës, kurrfarë ndarje e Kosovës dhe, po ashtu, asnjë shkëmbim territorial në mes të Kosovës dhe Serbisë", është shprehur Konjufca.

EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Lëvizja Vetëvendosje vazhdon ta kundërshtojë rolin prijës të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në dialogun me Serbinë. Në një konferencë për media të hënën, shefi i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se gathishmëria e vazhdueshme e presidentit Thaçi për të qenë në krye të delegacionit të Kosovës në dialogun me Serbinë, mund të jetë një lloj përpjekjeje për të shtyrë për pak muaj, siç tha ai, funksionalizimin dhe funksionimin e Gjykatës Speciale për krime

luftë, nga e cila, sipas Konjufcës, presidenti mund të ketë frikë. "Kjo tregon se Hashim Thaçi dialogun e ka jetik dhe ekzistencial. Ne mendojmë se kjo është jetike vetëm për personalitetin e tij, vetëm për karrierën e tij personale, për shkak se përmes kësaj mendon se, duke bërë kompromise dhe koncesione me Serbinë, ndoshta për pak muaj do të mund ta shtyjë Gjykatën Speciale nga funksionimi i saj. Mirëpo, ne jemi totalisht kundër që një person si ai të vihet në krye të dialogut, ta keqpërdorë këtë proces, të bëjë koncesione në kurriz të Kosovës dhe krejt kjo vetëm pse ai frikësohet nga proceset e tjera siç është ardhja në

shprehje dhe funksionimi i Gjykatës Speciale", ka thënë Konjufca.

Ai ka shtuar se Thaçi, me insis-

timin e tij që të jetë në krye të dialogut, e ka uzurpuar procesin. "E patë se si presidenti ia hoqi vijat e kuqe Serbisë. Në një

MKRS-ja lanson projekte kundër ekstremizmit të dhunshëm

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Të hënën nën përkujdesjen e ministrit Kujtim Gashi është mbajtur konferenca për lansimin e projekteve të përkrahura nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e sigurisë njerëzore, përkatësisht projektet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Pikërisht për këtë qëllim Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ofruar mbështetje financiare për 19 organizata të shoqërisë civile duke përfshirë këtu edhe qendra rinore, projekte këto që kontribuojnë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, për të cilat MKRS-ja është e mandatar.

Ministri Gashi ka bërë nënshkrimin e kontratave me përfituesit e këtij programi. "Duke qenë se ekstremizmi i dhunshëm është një dukuri globale dhe aktualisht përbën një kërcënim serioz ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, MKRS-ja mbetet e përkushtuar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm që ka për qëllim



parandalimin e ekstremizmit nëpërmjet mbështetjes së edukimit për tolerancë dhe aksesit në zhvillimet profesionale në mbarë vendin, me përfshirjen dhe angazhimin e institucioneve qendrore, lokale, si dhe komuniteteve fetare dhe shoqërisë

civile", ka thënë Gashi, duke shtuar se MKRS-ja do të bëjë përpjekje për të vazhduar dhe nxitur edhe më tutje vlerat demokratike si dhe për ta promovuar traditën e bashkëjetesës fetare midis komuniteteve. "Vizioni ynë i përbashkët është të kultivojmë një shoqëri që

mbështetet mbi respektin që ndajmë bashkërisht për të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës, barazinë dhe liritë themelore në Kosovë", ka thënë ministri Gashi. Ai ka shtuar se adresimi i këtyre sfidave me qëllim të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe

radikalizmit përbën një çështje urgjente për Republikën e Kosovës. "Andaj edhe një herë zotohemi se do t'i përmbushim të gjitha detyrimet tona për të cilën Qeveria e Kosovës ka mandatuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Strategjinë e Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015-2020", ka thënë Gashi.

Ndërsa Kreshnik Xharra, ushtrues detyre i drejtorit të Departamentit të Rinisë në MKRS, ka theksuar se presin bashkëpunim të frytshëm dhe serioz me organizatat. "Presim të kemi partneritet të frytshëm dhe seriozitet në realizimin e synimeve tona", ka thënë ai.

Mensur Morina nga organizata "Liza", përfitues i një projekti, ka thënë se do ta luftojnë radikalizmin e dhunshëm përmes realizimit të këtyre projekteve. "Jemi me fat që gjendemi këtu dhe jemi përfitues i një fondi. Do të luftojmë dhe do ta parandalojmë radikalizmin e dhunshëm që shpie në terrorizëm", ka thënë Morina

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë i bashkohet VALA-s

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli dhe ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Mentor Sylmeta, kanë nënshkruar të hënën marrëveshjen për shfrytëzimin e shërbimeve të VALA-s.


Të gjithë punonjësit e kësaj ministrie, duke përfshirë stafin dhe tërë administratën pa përjashtim, që nga dita e sotme do ta kenë mundësinë e përfitimit nga ofertat dhe produktet e VALA-s, ashtu siç kanë përfituar deri më tash shumë institucione qeveritare, publike, biznese private dhe grupmosha qytetarësh, të cilët tashmë janë rikthyer ose kanë kaluar në VALA. "Fakti që ne ofrojmë shërbimet më të mira dhe me çmimet më të lira, tregon se jo vetëm kjo Ministri sot, por shumë institucione shtetërore dhe pushtete lokale në të ardhmen do t'i bashkohen VALA-s, të bindur çdo ditë e më shumë në cilësinë e produkteve

tona", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli. Sipas tij, nënshkrimi i kësaj marrëveshje me Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë jo vetëm se do t'ua lehtësojë komunikimin tërë personelit të saj, por ata do të përfitojnë më shumë thirrje dhe më shumë internet të shpejtë brenda një pakoje të përzgjedhur. "Që nga sot stafi i Ministrisë sonë nuk do të kreditohet apo ngarkohet më me faturim të shpenzimeve personale për telefona mobilë me tarifa të larta, por tash e tutje do të kenë një mundësi të mirë të përfitimit me çmime tejet të favorshme", ka thënë Mentor Sylmeta.

Telekomi i Kosovës, VALA, edhe në të ardhmen do të synojë të kthej në familjen e vet institucione publike e shtetërore si dhe biznese e ndërmarrje private duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve për komunikim dhe internet sa më cilësor.



Posta nderon shkrimtarët Anton Pashku dhe Azem Shkreli



PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Në kuadër të tematikës "Personalitete të shquara", Filatelia e Postës së Kosovës ka emetuar pullat postare me imazhet e shkrimtarëve, Anton Pashku dhe Azem Shkreli. Anton Pashku lindi më 1937 në Has të Thatë të Prizrenit. Shkollimin e kreu në Prizren dhe Prishtinë, ndërsa tërë jetën punoi redaktor në gazetën "Rilindja". Tregimet e para i botoi në vitin 1957 me vizion të fuqishëm dhe largpamës. Veprat e Pashkut sjellin një frymë krejtësisht moderne në traditën e prozës shqiptare dhe realizohen përmes strukturimit të nëntekstit ironik të rëfimit që nxit dhe motivon lexuesit që ta kërkojnë atë që nuk thuhet, atë që duke heshtur, e bën lexuesin të jetë zëri kryesor. Anton Pashku u nda nga jeta në vitin 1995.

Azem Shkreli lindi më 1938 në Rugovë të Pejës. Shkollimin e kreu në vendlindje, kurse Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Ishte kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, drejtor i Teatrit Krahinor në Prishtinë dhe themelues e drejtor i Kosova Film. Azem Shkreli në radhë të parë shkroi poezi të rëndësishme duke e çliruar unin lirik intim nga ai kolektiv, duke trajtuar temën e dashurisë për vendlindjen, duke portretizuar njeriun e trullit rugovas me ngjyrimet e traditës dhe të lashtësisë, dashurinë për vashën, lirikën peizazhiste.



Bashkëpunimi mes institucioneve vendore krijon politika të mirëfillta ekonomike

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë (KIE), Shpend Balija, ka thënë se bashkëpunimi në mes të institucioneve vendore dhe sektorit privat është elementi kryesor i cili ndikon pozitivisht në zhvillimin e politikave të mirëfillta ekonomike

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 KORRIK - Këshilli i Investitorëve Evropianë (KIE) ka organizuar të hënën tryezën për diskutim me titull "Reforma e politikës fiskale dhe ndikimi i saj në sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik". Në këtë tryezë është diskutuar rreth reformave të politikës fiskale dhe impaktit të tyre në sektorin privat, veçanërisht Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK) si dhe Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP). Po ashtu, është diskutuar edhe për aspektet teknike të cilat kanë ndikim në sektorin bankar, sektorin e kompanive të sigurimit, tatimin mbi të drejtat pronësore, tatimin në dividendë dhe shumë e shumë aspekte të tjera të rëndësishme të veçantë.

Drejtori ekzekutiv i KIE-së, Shpend Balija, ka thënë se bashkëpunimi në mes të institucioneve vendore dhe sektorit privat është elementi kryesor i cili ndikon pozitivisht në zhvillimin e politikave të mirëfillta ekonomike. "Jam i kënaqur që sot ne po vazhdojmë dialogun dhe po e thellojmë

bashkëpunimin tonë në shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira me qëllim të eliminimit të barrierave afariste si dhe përafrimit të legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian duke dhënë kontributin maksimal për harmonizimin e legjislacionit si dhe eliminimin e mangësive legjislative të cilat kanë ekzistuar në të kaluarën", është shprehur Balija.

Kurse zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, ka falënderuar Këshillin e Investitorëve Evropianë për organizimin e këtij takimi, duke thënë se rekomandimet e kaluara të KIE-së janë zbatuar,

gjë që shërben si dëshmi e një bashkëpunimi të ngushtë me këtë institucion.

Gashi ka shtuar se Ministria e Financave ka zbatuar reforma në katër ligje: Ligji për Administratë, Ligji për TVSh-në, Ligji për të Ardhurat e Korporatave dhe Ligji për të Ardhurat Personale. Duke potencuar rëndësinë dhe gatishmërinë e bashkëpunimit me sektorin privat dhe investitorëve në Kosovë, në mënyrë që të nxitet zhvillimi ekonomik i vendit, Gashi ka deklaruar se kjo është mënyra më e mirë për të ndikuar në draftimin e mirëfillt të legjislacionit duke bashkëbiseduar

dhe duke marrë qëndrime të përbashkëta me sektorin privat rreth këtyre temave të rëndësishme.

Ndërsa Nahit Sharku nga ATK-ja ka thënë se një numër i madh çështjesh si fondi rezervë, shërbimet financiare dhe shpenzimet e ndodhura duhet të definohen në ligj. Ai ka deklaruar se fondi rezervë duhet të riformatohet në rezerva shtetërore. Gjithashtu, Sharku ka theksuar nevojën për t'i rishikuar ndëshkimet, pasi tanimë 90 për qind e tatimpaguesve janë pagues vullnetarë.

Ndërkaq Ramize Ramadani nga Banka Qendrore e Kosovës

(BQK) ka thënë se sektori i sigurimeve në Kosovë përbën vetëm tre për qind të tregut të përgjithshëm. "Ky sektor është ballafaquar me humbje dhe me tatime të mëdha. Shumica e familjeve në Kosovë nuk janë të siguruara, që tregon se ka potencial të madh për zhvillim të këtij sektori në të ardhmen", është shprehur ajo. Në këtë tryezë u elaborua gjerësisht mbi aspektet profesionale dhe teknike të cilat duhet të përfshihen në këto dy draftligje. Pjesëmarrësit, po ashtu, bënë thirrje të ketë sa më tepër harmonizim ndërinstitucional në mënyrë që ligjet të janë të implementueshme.

OEK-u pajtohet të shuhet Organi Shqyrtues i Prokurimit

Prishtinë, 2 korrik (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka përkrahur deklaratën e ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, për shuarjen e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). OEK-u ka vlerësuar se OSHP-ja ka gjeneruar më së shumti amulli në vendimmarrje, politizim të skajshëm të vendimeve, promovim të tenderomanisë favorizuese, gjenerim të korrupsionit,



pakonkurrueshmësisë fer për bizneset vendore e ndërkombëtare, në veçanti dëmtim të

imazhit të Kosovës në përmasa të mëdha. "Duke pasur parasysh faktin se Kosova

ballafaqohet me sfida të shumta që ndikojnë në ambientin e të bërit biznes dhe emëruesi i përbashkët i zgjidhjes së gjitha këtyre problemeve është sundimi i rendit dhe ligjit, sundim i rendit dhe ligjit i cili aktualisht nuk është në nivelin e dëshiruar, mendojmë se shuarja është zgjidhja më adekuate për momentin, por në të njëjtën kohë OEK kërkon përgjegjësi për veprimet korruptive në

këtë organ me qëllim të ndëshkimit dhe të rritjes së përgjegjësisë individuale dhe institucionale. Prandaj, mbështesim fuqishëm një rekomandim të tillë që do të ndikojë në përmirësimin e imazhit të Kosovës, promovimin e sundimit të rendit dhe ligjit dhe përmirësimin e imazhit përballë investitorëve vendorë dhe ndërkombëtarë", është thënë në komunikatën e OEK-ut.

Iu dha lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare, Bajrush Behrami

Behrami u përket emrave që jetojnë edhe pas vdekjes

Në varrezat e qytetit të Besianës të hënën i është dhënë lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare, Bajrush Behrami, ku ishin të pranishëm zyrtarë të institucioneve të Kosovës, përfaqësues lokalë, përfaqësues të organizatave të luftës së UÇK-së dhe qytetarë të shumtë. Ndërkaq në mbledhjen komemorativë e cila u mbajt në Teatrin Kombëtar në Prishtinë u tha se Bajrush Behrami i ka pasur të gjitha virtetet që i ka një patriot, mençurinë, gatishmërinë për sakrificë, por edhe përkushtimin që deri në fund ta ndjekë idealin e lirisë së Kosovës

BESIANË, 2 KORRIK (ER) - Të hënën i është dhënë lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare, Bajrush Behrami, në varrezat e qytetit të Besianës, ku ishin të pranishëm zyrtarë të institucioneve të Kosovës, përfaqësues lokalë, përfaqësues të organizatave të luftës së UÇK-së dhe qytetarë të shumtë. Po të hënën është mbajtur edhe një mbledhje komemorativë në Teatrin Kombëtar në Prishtinë për të ndjerin Bajrush Behrami. Në këtë mbledhje komemorativë u tha se Bajrush Behrami i ka pasur të gjitha virtetet që i ka një patriot, mençurinë, gatishmërinë për sakrificë, por edhe përkushtimin që deri në fund ta ndjekë idealin e lirisë së Kosovës. Në emër të bashkëveprimtarëve, Hamit Hamiti ka thënë se për një burrë si Bajrush do të kishte nevojë Kosova dhe institucionet e saj, veçanërisht institucioni ku

jetë", ka thënë ajo. Vdekja e hershme e Behramit, përpos familjarëve, ka lënë të pikëlluar



punonte, Qendra e Studentëve. Ai ka thënë se një jetë të tërë Bajrush i kushtoi për ta bërë lirinë. Ndërkaq kryetari i shoqatës së veteranëve të UÇK-së, dega në Besianë, Fahri Balaj, ka thënë se të qenit UÇK, Bajrush i bëri haptazi në Prishtinë, në zyrën e informimit të UÇK-së, në të cilën veprroi bashkë me Adem Demaçin.

Kurse zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka theksuar se emri i Bajrush Behramit jetësohet me lirinë tonë dhe me idenë e shtetit të pavarur të Kosovës, meqë ai çdoherë në zemër dhe mendje e ka pasur Kosovën e lirë dhe Kosovën e pavarur.

Vajza e Bajrushit, Dalmanë Behrami, ka thënë se disa njerëz lindin për të mos vdekur kurrë. "Më kanë thënë që disa gjëra që i do, duhet t'i lësh të shkosh, unë të dua ty shumë, prandaj po të lësh të shkosh. Pusho i qetë, babë. Ti je gjithmonë brenda meje sepse mua dhe dhembjen vetëm një litar i hollë dhe i fortë na ndan në këtë

miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se vdekja e veprimtarit të shquar Bajrush Behrami është humbje e madhe për familjen miqtë dhe gjithë brezin e tij politik me të cilin punoi dekada të tëra. "Bajrush i ishte një nga organizatorët e demonstratave të vitit 1981, i burgosur politik për vite të tëra dhe mbështetës i pakompromis i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Presidenti ka thënë se Bajrush Behrami dha kontribut të çmuar



edhe në ndërtimin e jetës institucionale pas luftës. "Ai u shqua për talent në artin e vizatimit dhe pikurës, duke lënë prapa vetes një trashëgimi artistike, që shprehte shpirtin e tij artistik dhe bindjet atdhetare. I përjetshëm qoftë kujtimi



"Në vitet 1998 dhe 1999 me Bajrushin kemi punuar bashkë në zyrën e UÇK-së në Prishtinë, të udhëhequr nga përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi", ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se për Bajrush Behramin ka kujtimet më të mira dhe përvojat më të vlefshme nga

ynë për të mbeten të përjetshëm", ka shkruar Kurti.

Kryetari i Komunës së Besianës, Agim Veliu, ka thënë se me ndarjen nga jeta të Bajrush Behramit humbëm njeriun e mirë, intelektualin dhe veprimtarin e devotshëm të çështjes kombëtare. "Me ndarjen nga jeta të Bajrush Behramit humbëm njeriun e mirë, intelektualin dhe veprimtarin e devotshëm të çështjes kombëtare. Me shpirtin e tij prej artisti dhe guximin e madh prej luftëtari, Bajrush kontribuoi dhe i dha shumë vendit dhe shoqërisë. Ikja e tij e hershme në përjetësi është një humbje e madhe, jo vetëm për familjen dhe miqtë, por edhe për Kosovën. Pusho i qetë në tokën e Kosovës së cilës ia kushtove jetën!", ka shkruar Veliu në llogarinë e vet në "Facebook". Bajrush Behrami ndërroi jetë të dielën në moshën 61-vjeçare pas një sëmundje të shkurtër. Ai ishte edhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe kryetar i Partisë Unitetit Kombëtar "UNIKOMBI". Behrami, lindur në vitin 1956 në Dobratin të Besianës, kohët e fundit ka punuar në Qendrën Studentore.



ato kohë të vështira. "Vdekja e tij më dhemb. Një botë e tërë e vuarjtjeve dhe mirësisë në një njeri të vetëm më duket se na iku. Vdekjen e pati të parakohshme, por kontributi i tij për ne e kujtimi

për jetën dhe veprën e tij!", ka shkruar presidenti.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili ka punuar me Behramin në Zyrën e UÇK-së në Prishtinë, ka thënë se me pikëllim e ka marrë lajmin për vdekjen e tij.



Kompromiset e reja do ta zhbënin shtetin e Kosovës. Ja pse



Milazim KRASNIQI

Ambasadori amerikan në Beograd, Kajll Skot, ka deklaruar se mund të shpresohet për kompromis të ri ndërmjet Serbisë e Kosovës, bile ndoshta gjatë këtij viti. Optimizmi i ambasadorit për kompromiset e reja, e ka brenda vetes jo vetëm shtirjen diplomatike për një publik dyshimtar ndaj shtetit të tij, sikundër që janë serbët ndaj ShBA-ve, por edhe elementë të një projekti pothuajse të finalizuar për një "marrëveshje gjithëpërfshirëse" ndërmjet Serbisë e Kosovës. Po qe se dëgjohen me vëmendje deklaratat e presidentit të Kosovës, ato shkojnë në të njëjtën linjë, pra, të kompromiseve të reja që u dashka

të bëjë Kosova. Bile ideja e re për kompromise, po paktohet disi në mënyrë argëtuese si "win-win", demek mirë për të dyja palët. Por, në këtë rast nuk mund të jetë mirë për të dyja palët, thjesht ngase Kosova më nuk ka çka të japë, përveç nëse ia marrin edhe shpirtin e saj si shtet. Prandaj, pyetja dramatike në këtë kontekst është kjo që sapo po parashtrohet: çfarë kompromisesh të tjera mund të bëjë Kosova, kur ka bërë kompromise, të cilat e kanë shndërruar në shtet të dështuar? Kompromiset maksimale janë bërë në Vjenë, me idenë se Plani i Ahtisarit do të pranohej dhe Kosova do të merrte ulëse në OKB. Ndërsa Serbia e refuzoi Planin e Ahtisarit, ama i mori favorët e kompromiseve që bëri Kosova me pranimin e atij plani. Kështu Serbia mori maksimumin e favoreve, pa marrë asnjë obligim, për ç'arsye vazhdoi e papenguar destabilizimin e Kosovës deri në ditët e sotme. Për ata që janë qëllimisht harrestarë, po evokojmë se cilat kompromise i ka bërë Kosova ndaj Serbisë deri sot e të cilat e kanë sjellë në prag të dështimit si shtet funksional:

1. Kosova e ka pranuar juridiksionin e Kishës Ortodokse Serbe mbi tërë Kosovën, ndonëse qëndrimi i kësaj kishe ndaj shtetit tonë është tmerrë-

sisht armiqësor. Popat serbë pengojnë ndërtimin e rrugëve nëpër Kosovë, pasi me Planin e Ahtisarit, një territor të madh e kanë shndërruar në "zona të mbrojtura". Popat serbë zdërhallen lirisht nëpër Kosovë duke kërcënuar se do ta shkatërrojnë shtetin e Kosovës me luftë. Ndërsa, po ky shtet i lejon Kishës Ortodokse Serbe edhe lehtësime doganore e gjithfarë, që të sillen këtu si në bahçen e babës. Definitivisht duhet të thuhet se ky kompromis është destabilizues dhe madje kërcënues për vetë ekzistencën e shtetit tonë.

2. Kosova ka bërë kompromise të rënda, duke formuar komuna rurale për serbë, pa asnjë logjikë ekonomike. Këto komuna rurale e kanë prishur unitetin demografik e ekonomik të disa zonave dhe si të tilla paraqesin pengesa për komunikim e për zhvillim normal të vendit.

3. Kosova ka bërë kompromise poshtëruese për veten si shtet, duke lejuar që tash 18 vjet serbët lokalë të mos paguajnë as rrymën, as ujin, as shërbimet e tjera, ndërsa nga ana tjetër e gjithë jeta e tyre sociale financohet nga buxheti i këtij shteti. Kësi kompromisi nuk mund të gjendet as në Tunguzi.

4. Kosova ka bërë kompromise të pamoralshme, duke hequr dorë nga e drejta që të inicioje

në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë padi për gjenocid kundër Serbisë. Po ashtu ka mbyllur të dy sytë dhe nuk ka ndjekur penalisht kriminelët serbë që kanë kryer krime në Kosovë, shumë prej të cilëve edhe më tutje jetojnë në Kosovë.

5. Kosova ka bërë kompromise të ulëta, duke lejuar mbajtjen e zgjedhjeve lokale, parlamentare e presidenciale të Serbisë në territorin e Kosovës. Ky tolerim bizar e ka ushqyer irredentizmin e serbëve të Kosovës dhe i ka siguruar se parulla "Kosova është Serbi" nuk është vetëm slogan propagandistik.

6. Kosova ka bërë kompromise idiotike, duke lejuar importin e mallrave serbe pa karar, ndërsa Serbia me atë profit ka financuar shërbimet e veta sekrete në Kosovë, si edhe gjithë administratën paralele që mban në funksion.

Ka edhe kompromise të tjera të shumta, po vetëm këto që u numëruan, dëshmojnë se Kosova ka ardhur në prag të zhbërjes si shtet, për shkak të kompromiseve që ka bërë ndaj Serbisë tash 18 vjet. Kosova de facto ka kapitulluar në paqe në raport me Serbinë.

Natyrisht e gjitha është bërë me presionet mbi Kosovën të aleatëve të saj, të ShBA-ve, NATO-s e BE-së. Ata duke e

marrë me të mirë Serbinë, gjasme për ta larguar nga Rusia, i kanë dhënë favore të shumta në Kosovë, thjesht duke ia zënë Kosovës frymën si shtet. Ka mbetur vetëm edhe një gjë ta bëjnë: zhbërjen formale të shtetit të proklamuar të Kosovës, si kompromis i fundit. Këtë po e synojnë tash, si kryekompromis, duke krijuar një "Republika Serpka" në territorin e Kosovës. Nëse e formojnë një "Republika Serpska", ne shqiptarëve na mbeten dy rrugë: ose ta pranojmë zhbërjen e shtetit tonë si kryekompromis, ose t'ia nisim çlirimit të Kosovës që nga fillimi. E dyta është mision i rëndë, e para, nuk duhet të merret fare në konsiderim. Për të mos ardhur puna bash deri aty, duhet që të refuzohet kategorikisht kjo formë e dialogut, ku kërkohen kompromise që e dezintegrojnë shtetin tonë me një "Republika Serpska" në territorin tonë. Një formë e refuzimit është të shpallen zgjedhjet e reja dhe pas tyre të formohet një qeveri e shpëtim-it kombëtar, e cila do të jetë e aftë të mbrojë interesat e vendit edhe nga miqtë tanë, të cilët duket se e kanë humbur sensin e masës lidhur me kompromiset e Kosovës. Me kësi miqsh, armiqtë nuk të duhen, do të thoshte Zhan Klod Junkeri.

Ndarja territoriale, çmim fatal në Ballkan

imsjellëse. Preferenca e vjetër serbe, në fakt ndarja territoriale, është opsioni që fare nuk i duhet jo vetëm Kosovës, por tërë Ballkanit.

Opsioni i vjetër i preferuar për Serbinë tashmë vërehet se po vihet në sipërfaqe sërish, vite e dekada pas tentimeve të dështuara. Porse, ndarja e Kosovës nuk është zgjidhje. Ajo, në fakt, është rifillimi i problemeve dhe destabilizimit në Ballkan, është hapje e një procesi për ridefinimin e kufijve në regjion, madje edhe vënien në pikëpyetje të ekzistencës së shteteve fqinje.

Orientimi i shqiptarëve në Ballkan asnjëherë gjatë historisë nuk ka qenë destabilizimi apo politikat shoviniste. E kundërta ka qenë përgjigjja e Serbisë edhe gjatë kohës së ish-Jugosllavisë. Shpërbërja e dhunshme e

shtetit jugosllav ka treguar se Kosova ka qenë e vetmja njësi e federatës që ka tentuar dhe është angazhuar të mos kontribuojë në valën e tmerrshme të dhunës. Kosova u përball me nevojën e luftës, si mjet i domosdoshëm për çlirimin e vendit. Ndihi e bashkësisë ndërkombëtare në krye me ShBA-në doli të jetë vendimtare për të na mundësuar të jetojmë të lirë në Kosovë.

Përpjekjet e sërishme të Serbisë për ta vendosur ndarjen territoriale të Kosovës si zgjidhje e problemit duhen parë si të pazbatueshme dhe destabilizim-sjellëse. Edhe në praktikat e tjera është dëshmuar se opsioni i ndarjes është opsion i dhimbjeve, vështirësive, deportimeve apo transferimeve, koncentrimëve, krizave humanitare

dhe problemeve ligjore. Kjo është pjesa e parë e shpjegimit të problemit të ndarjes së Kosovës. Do të thotë, në një rast të tillë do të kemi krizë humanitare të shpërnguljes së popullatës shqiptare dhe serbe nga njëra pjesë në tjetrën, do të kishim probleme me pronat e tyre dhe probleme të ngjashme. Porse ky problem është shumë i vogël në krahasim me atë që do të mund të përballeshim nëse opsioni i ndarjes arrin të fitojë përkrahje më të gjerë. Duke e parë si të rrezikshme këtë skenar të mundshëm të zhvillimeve të ngjarjeve, besoj se është krusiale për bashkësinë ndërkombëtare refuzimi me forcë i ndarjes së Kosovës, madje edhe i tentimeve të Serbisë për të vendosur në tavolinë e për të biseduar rreth saj në çfarëdo forme qoftë.

Organizimi i shtetit të Kosovës vetëm në një pjesë të territorit të saj nuk ka kuptim. Po ashtu, nuk kanë kuptim më as tri parimet prijëse të Grupit të Kontaktit. Kosova nuk do të mund ta qetësonte frustrimin e qytetarëve që kanë humbur shumë në tërë këto dekada. Zërat për bashkimin në një shtet me Shqipërinë do të dilnin ditat. Nuk do të mund ta ndërtonim asnjë njeri, madje as prej balte, që do të mund të argumentonte se shqiptarët në Ballkan nuk duhet të krijojnë një shtet të vetëm. Në një Ballkan të rivizituar kufijsh, stabiliteti ndoshta do të mund të arrihej, por çmimi për të do të ishte fatal. Fitore e Pirros do të mund të quhej kjo për të gjithë ballkanasit, duke e paguar këtë në mënyrë krejt më të veçantë.



Burim RAMADANI

Orvatjet e sërishme të Serbisë për ta vendosur ndarjen territoriale të Kosovës si zgjidhje e problemit duhen parë si të pazbatueshme dhe destabiliz-

Arrestohen dhjetëra kolonelë në Turqi

ANKARA, 2 KORRIK - Turqia ka urdhëruar ndalimin e 68 të dyshuarve, duke përfshirë dhjetëra kolonelë, në një operacion që ka shënjestruar

mbështetësit e supozuar të klerikut fetar Fethullah Gulen, të cilin Ankaraja e akuzon për orkestrim të tentimeve të dështuara për puç

dy vjet më parë, ka njoftuar agjencia shtetërore turke "Anadolu". Nëntëmbëdhjetë zyrtarë në detyrë janë në mesin e personave që do të

përballen me ndalim, në operacionin e zgjeruar në 19 provinca, duke përfshirë kryeqytetin turk, Ankaranë.



Në Belgjikë arrestohen dy persona që komplotuan sulm terrorist

BRUKSEL, 2 KORRIK - Autoritetet belge kanë njoftuar se kanë arrestuar një burrë dhe një grua nën dyshimet se kanë planifikuar të sulmojnë një ngjarje të fundjavës, të organizuar nga një grup i opozitës iraniane në Francë.

Të dyshuarit u arrestuan të shtunën në rajonin e Brukselit dhe u akuzuan për komplot për të sulmuar një konferencë të organizuar nga organizata Mujahedin-e Khalq, e cila u mbajt pranë Parisit, njoftoi të

hënën prokuroria belge. Sipas saj, të dyshuarit, të identifikuar si Amir S. dhe Nasimeh N., të dy shtetas belge, janë në të tridhjetat. Prokurorët thanë se çifti është ndaluar me makinën e tij, ku janë gjetur rreth gjysmë kilogrami eksploziv TATP dhe një tjetër lëndë plasëse.

Pas arrestimeve, policia bastisi edhe pesë shtëpi, por nuk dha detaje të tjera.

Organizata Mujahedin-e Khalq mbështet rrëzimin e udhëheqjes së Iranit.

Lopez Obradori, president i ri i Meksikës

Kandidati i së majtës, Andres Manuel Lopez Obrador, ka fituar mes shifrave 53 % të votave të zgjedhjeve presidenciale që u zhvilluan të dielën në Meksikë. Ai ka garuar me platformën e luftës kundër korrupsionit dhe uljes së varfërisë duke fituar mbështetjen e votuesve të irrituar nga partitë tradicionale si ajo e presidentin në largim Enrique Pena Nieto

MEKSIKO SITI, 2 KORRIK -

Në Meksikë, 64-vjeçari i krahut të majtë Andres Manuel Lopez Obrador, i cili e filloi karrierën në politikë dekada më parë, si mbrojtës i të drejtave të banorëve indigjenë, ka fituar në zgjedhjet presidenciale të vendit. Ai ka garuar me platformën e luftës kundër korrupsionit dhe uljes së varfërisë duke fituar mbështetjen e votuesve të irrituar nga partitë tradicionale si ajo e presidentit në largim Enrique Pena Nieto.

Lopez Obrador bëri thirrje të dielën për "marrëdhënie më të mira" me Shtetet e Bashkuara. "Ne do të kërkojmë një marrëdhënie më të mirë me qeverinë amerikane bazuar në miqësi dhe zhvillim, gjithmonë nisur nga respekti i ndërsjellë dhe në mbrojtje të bashkatdhetarëve tanë, emigrantëve që jetojnë dhe punojnë në atë vend", ka thënë



Obrador.

Duke folur për sfidat e brendshme të Meksikës, Lopez Obrador, ka pohuar se çrrënjësja e korrupsionit dhe e mosndëshkimit do të jetë misioni kryesor i qeverisë së tij dhe ai nuk do të "zhgënjejë" popullin meksikan. "Unë përsëris premtimin tim për të mos e tradhtuar besimin tuaj të cilin miliona meksikanët kanë vendosur tek unë. Unë do të qeveris me ndershmëri dhe drejtësi, nuk do të dështoj, nuk do t'ju zhgënjej dhe nuk do ta tradhtoj popullin tim", ka thënë

presidenti i ri i Meksikës. Presidenti amerikan Donald Trump e ka përgëzuar Obradorin për fitoren përmes profilit të vet në "Twitter". "Urime për Andres Manuel Lopez Obrador që do të jetë presidenti i ardhshëm i Meksikës! Mezi pres të punoj me të. Ka shumë gjëra që mund të bëjmë në të mirë të Shteteve të Bashkuara dhe Meksikës!", ka shkruar Trump.

Të dy kundërshtarët e Obradorit në zgjedhjet e së dielës, Jose Antonio Meade, i partisë PRI në pushtet dhe Ricardo Anaya i partisë PAN, i uruan atij suksese për mirëqenien e Meksikës. Këto janë zgjedhjet e para presidenciale që fitohen nga partia e Obradorit, Lëvizja Kombëtare e Ringjalljes (MORENA), e cila ka formuar një koalicion me Partinë Laburiste të krahut të majtë dhe Partinë Socialiste të së djathtës. (Voa)

Rohani në Evropë, në përpjekje për ta shpëtuar marrëveshjen bërthamore

BERN, 2 KORRIK - Presidenti i Iranit, Hassan Rohani, ka nisur të hënën turneun në Evropën perëndimore, për të diskutuar fatin e marrëveshjes bërthamore midis Teheranit dhe gjashtë fuqive botërore. Udhëtimi i Rohanit në Zvicër dhe Austri është pjesë e përpjekjeve diplomatike të Republikës Islamike për të mbledhur mbështetje, pas tërheqjes së Shteteve të Bashkuara nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015.

Përpara se të nisej nga Teherani, Rohani ka deklaruar se pret që vendet evropiane të shpalojnë në ditët e ardhshme disa masa për ruajtjen e marrëveshjes.

Presidenti amerikan, Donald Trump, e ka tërhequr ShBA-në nga marrëveshja në muajin maj dhe ka rikthyer sanksionet kundër Iranit.

Zyrtarët amerikanë i kanë paralajmëruar edhe vendet e tjera se mund të përballen me sanksione nëse nuk ndalojnë të bëjnë biznes me Teheranin.

Vendet e tjera nënshkruese të marrëveshjes, Britania, Franca, Rusia, Kina dhe Gjermania,



kanë thënë se mbeten të përkushtuara në zbatimin e saj, përderisa Irani e respekton. Me këtë marrëveshje Irani e ka frenuar aktivitetin bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare. Rohani të martën do të takohet me presidentin e Zvicrës Alain Berset dhe zyrtarë të tjerë. Ndërkaq, më 4 korrik, Rohani do ta takojë homologun nga Austria, Alexander Van der Bellen, dhe kancelarin e këtij vendi, Sebastian Kurz, në Vjenë.

OKB-ja zvogëlon buxhetin për misionet paqeruajtëse

GENEVË, 2 KORRIK - Shtetet anëtare në Kombet e Bashkuara janë pajtuar për ta zvogëluar buxhetin vjetor për misionet paqeruajtëse, kanë njoftuar burime diplomatike për agjencinë e lajmeve "AFP". Agjencia "AFP" ka raportuar se

shuma, 6.689 miliardë dollarë, është për 122 milionë dollarë më e vogël se shumata e rekomanduar në fillim dhe rreth 600 milionë dollarë më e vogël se shumata e ndarë vitin e kaluar.

OKB-ja ka rreth 100 000 paqeruaj

jtës të angazhuar në 14 misione në botë.

Shtetet e Bashkuara kanë qenë kontribuueset kryesore në buxhetin e vitit të kaluar me 28.5 për qind të fondit, të përcjella nga Kina me 10.3 për qind dhe Japonia me

9.7 për qind. Në muajin mars, ambasadorja amerikane në këtë organizatë, Nikki Haley, ka thënë se Uashingtoni është duke planifikuar zvogëlimin e fondit, duke u bërë thirrje shteteve të tjera për ndarje të shumave më të mëdha.



Me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriot
Skënderbeut dhe 242-vjetorit të Pavarësisë së ShBA-së

Profesori amerikan Bollduin për Skënderbeun

**Prof. asoc. dr. Lirak
KARJAGDIU**

Shqiptarët si një nga popujt më të lashtë të Evropës dhe pasardhës të ilirëve kanë qenë dhe janë objekt i shkrimeve jo vetëm me karakter historik e gjuhësor, por edhe i krijimeve të mirëfillta letrare-artistike. Këto shkrime janë më të vjetra se libri i parë i letërsisë shqipe, "Meshari" i Gjon Buzukut i 1555-s. Madje këto shkrime datojnë që nga koha e Antikitetit. Kështu, Iliria dhe ilirët përmenden në veprat historike të Tit Livit, Plinit e Plutarkut, por edhe të Plautit, Ovidit, Horacit, Klaudianit, bile edhe të Eskilit dhe Homerit. Ndërkaq, figura e Skënderbeut është trajtuar në gjuhën angleze nga një numër autorësh anglezë dhe amerikanë, si Edmund Spenser, William Havard, George Lillo, Thomas Wincop, Benjamin Disrael, Clement Clark Moore, H. Longfellow, Agnes Repplier, Lord Byron dhe për ato vepra është shkruar kohë pas kohe nga studiues tanë dhe të huaj. Por, unë dëshiroj të veçoj këtu se çfarë tha profesori i njohur amerikan Bollduin për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun

në një ligjëratë të tij të mbajtur para shqiptarëve të Amerikës. Në vigjiljen e shekullit të shkuar, kur shqiptarët e Amerikës i kishin hyrë një organizimi plot entuziazëm për formimin e shoqatave të para, të themelimit të Kishës Autoqefale Shqiptare, të botimit të së përkohshmes "Kombi" e më pas "Dielli", u përpoqën që të venin kontakte e të gjenin miq dhe në mesin e amerikanëve. Udhëheqësit shqiptarë nga shqiptarët e mërguar, Noli, Peci, Konica, etj., ia dolën mbanë që të formojnë edhe shoqatat e para të miqësisë shqiptaro-amerikane. Dashamiri i çështjes shqiptare, anëtar i një shoqate të parë shqiptaro-amerikane dhe një i njohur i Nolit, profesori amerikan Bollduin, më 8 maj 1908, në Xhejmstaun, para shqiptarëve të tubuar me rastin e festës së Shën Gjergjit, mbajti një ligjëratë interesante për heroin legjendar kombëtar shqiptar, Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Më atë rast, profesori amerikan, nga veprat dhe cilësitë e Skënderbeut nxori edhe një mesazh për shqiptarët. Çfarë ishte mesazhi i heroit kombëtar për shqiptarët e sotshëm? Bollduin ishte i mendimit se për



të njohur një popull sa më mirë, do studiuar cilësitë, veprimet dhe idealet e njerëzve më të spikatur të atij kombi. Heronjtë, thekson ai, janë "majat më të larta" ku janë drejtuar sytë e popullit. "Tregomi heronjtë e një kombi e të tregoj se me ç'komb ke punë", pohon Bollduin. Duke bërë fjalë për Skënderbeun, ai e shfaq admirimin e tij për të që në fillim, sepse për të Skënderbeu ishte një vigan si në tiparet fizike, ashtu dhe mendore; ai pati një karakter të fortë, burrëri të rrallë e aspirata të qarta, prandaj i shërbeu atdheut dhe vdiq për të. Bollduini i qaset figurës së Skënderbeut, jo aq nga botëkuptimi i shekullit XX, po bën orvatje ta kuptojë e ta interpretojë fenomenin Skënderbe në saje të disa kriterëve të kohës së Skënderbeut. Profesori Bollduin

vë në dukje se guximi i Skënderbeut i siguroi atij përkrahjen e parë të shqiptarëve. "Pas kthimit në Krujë, ai u prit me përzemërsi të thellë nga bashkatdhetarët", thotë ai, "ndërsa me bashkimin e popullit të përçarë doli në shesh jo vetëm fuqia e tij e madhe prej prijësi, po tregoi se ishte i zoti të luftonte si për lirinë e shqiptarëve, ashtu edhe të "mbarë Evropës". Ai ua ktheu krenarinë shqiptarëve, "të cilët si një racë burrërore, kishin vendosur të gjithë që të jetonin e të vdisnin për princin e tyre". Nuk duhet harruar se në atë epokë, oboret e Sulltan Muratit II kishin dërrmuar e shpartalluar një sërë ushtrish të komandantëve të vendeve ballkanike. Në këtë mënyrë, Sulltani, "po e qante rrugën për pushtimin e Evropës", rikujton Bollduin. Më tej ai vazhdon: "Ambicia e tij ishte pushtimi i tërë Evropës, por në Skënderbeun me të 15 mijë luftëtarët e tij në fortesat e tyre shkëmbore, Murati II hasi në pengesën e cila i ndali hovin atij dhe pengoi që ta pushtonte Evropën". Ndërkaq, lidhur me disa tipare dhe cilësi të Skënderbeut, Bollduin vëren se sjelljet e tij ishin të rëndomta, meqë nuk dëshironte të dallohej

nga shokët, por "ai i përmbahej një disipline të rreptë, kështu që në ushtrinë e tij ish ndaluar çdo dobësi e padrejtësi". Përveç kësaj, ai konstaton se heroit kombëtar shqiptar kishte edhe këto cilësi: qëndrueshmëri, durimin, zgjuarsinë, vendosmërinë, besnikërinë, fisnikërinë, gatishmërinë dhe përvojën e rryer. "Shembulli i tij individual", përfundon ai, "e përforcoi komandën e tij, prandaj nën komandën e tij shqiptarët e bënë të pathyeshëm". Në fund, Bollduin arrin të bindet se çelësi i suksesit të triumfit të Skënderbeut ishte gatishmëria e tij. Së këndejmi, mesazhi i tij për shqiptarët e shekullit XX-të do të ishte që "para se të sulen në luftën për liri, duhet të përgatiten tërësisht". Por, shton ai, për ta arritur këtë qëllim, "Skënderbeu do ta bashkonte më parë tërë kombin shqiptar". I frymëzuar nga figura madhore e heroit shqiptar, profesori amerikan përfundon: "A s'ka sot mes jush një Skënderbe, me durimin, vendosmërinë, largpamësinë, pikëpamjet e drejta dhe besnikërinë për ta arritur këtë ideal madhështor?" Kjo është porosia e atij shpirti fisnik për bashkatdhetarët e tij.

Hapet ekspozita 'Gjergj Kastrioti Skënderbeu në veprat e artistëve evropianë'

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka hapur të hënën ekspozitën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në veprat e artistëve evropianë" të autorit Eqrem Zenelaj, ku janë prezantuar mbi 80 punime. Drejtori i Agjencisë së Arkivave të Kosovës, Ramë Manaj, ka thënë se bashkëpunimi me autorin Eqrem Zenelaj dhe kontributi i tij ia ka mundësuar Kosovës plotësimin e fondeve me të dhëna për Skënderbeun.

"Ky vit është shpallur vit mbarëkombëtar dhe vazhdimisht gjithandë hapësirave shqiptare i janë kushtuar ngjarje kryeheroit tonë. Në ekspozitën e sotme janë mbi 80 punime që janë vjelë nëpër arkiva të njohura të botës me përkujdesjen e veçantë të profesor Zenelajt", ka deklaruar Manaj. Kurse autori i ekspozitës, Eqrem Zenelaj, para të pranishmëve paraqiti disa nga faktet nga jeta dhe vepra e Skënderbeut. Ai ka thënë se Skënderbeu nuk është vetëm emblemë kombëtare, por edhe e Evropës dhe e botës.



"Përveç që ekzistojnë buste të Skënderbeut nëpër shumë të kryeqyteteve të botës, shumë autorë botërorë kanë folur për këtë figurë të lartë. Skënderbeu

ishte lideri më i famshëm dhe më i pamposhtur. Këtë vit është 550-vjetori i Skënderbeut. Është spekuluar shumë rreth ditëlindjes së Skënderbeut, mirëpo ai ka

lindur në vitin 1414. Unë e kam getur një letër në Venedik, ku thotë se Skënderbeu për nga madhësia ishte i jashtëzakonshëm", ka thënë Zenelaj.

E jashtëzakonshme

Pas moshës 105 vjeç ulet rreziku nga vdekja

Jetëgjatësia e njerëzve mund të rritet me kohën. Një studim i fundit pretendon se, pas moshës 105-vjeçare, rreziku i vdekjes te njerëzit ngadalësohet e në disa raste ulet. Shkrimi në revistën "Science" tregon se maksimumi i caktuar i jetëgjatësisë nuk është mbërritur ende dhe ajo e njerëzve faktikisht po vjen në rritje. Vendet e 100-vjeçarëve sot vazhdojnë të konsiderohen Japonia dhe Italia,



e në të dyja rastet, faktorë kryesorë të këtij fenomeni konsiderohen dieta ushqimore dhe aktiviteti fizik.

BARSOLETA E DITËS



I troket Hysenit vdekja në derë:
- Kam ardhur për shpirtin tënd.
Hyseni kthehet dhe bërtet:
- Razë, shpirt, po të lypë dikush.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



FOTO E DITES



Dy migrantë në Marsa të Maltës shihen duke pritur për t'u intervistuar nga autoritetet e këtij shteti /Reuters/

Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.



E rrallë

U shpall e vdekur, gruaja 'ringjallet' në frigoriferin e morgut

Një grua nga Afrika e Jugut është dërguar për trajtim mjekësor në spital, pasi është zbuluar se ishte e gjallë në një frigorifer morgu. Kompania e ambulancës që mori trupin e saj "Distress Alert", në një reagim zyrtar ka njoftuar se ajo nuk kishte shfaqur asnjë formë jete



gjatë transportimit për në morg. Por, kur një punëtor i morgut u kthye për ta kontrolluar trupin në frigorifer, ai pa se gruaja po merrte frymë.


Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Sot do të jetë një ditë plot energji për ju. Po jepni shumë në një drejtim të caktuar dhe pretendimet tuaja janë rritur po kaq. Do të kërkonte atë që ju takon.



DEMI

Po shikoni me zili ata persona që, edhe pse nuk mundohen fare, arrijnë atë që duan. Nga ana tjetër ju po bëni edhe punët e të tjerëve pa u vlerësuar.



BINJAKËT

Miqësitë janë ato që do të favorizohen sot dhe mund ta marrin të gjithë ditën tuaj. Jeni të gatshëm të qëndroni pa fund me miq të mirë.



GAFORRJA

Kjo e sotmja nuk do të jetë nga ato ditë që do të donit t'i kujtonit. Do të keni probleme që në mëngjes herët dhe do t'ju shoqërojnë përgjatë gjithë ditës.



LUANI

Po ju pëlqen çdo gjë që bëni sot si të rini në shoqërinë e familjarëve ashtu edhe kënaqësia që po ndjeni në ambientin e punës pas një projekti të realizuar.



VI RGJËR ESHA

Disa hije dyshimi ju kanë filluar për një raport të nisur së fundmi. Jeni në kohë të mendoheni dhe të tërhiqeni nëse gjërat nuk ju pëlqejnë.



PESHORJA

Sot ju duket sikur gjithë bota e ka me ju dhe jeni i vetëm kundër të gjithëve. Mbase nuk jeni zgjuar me energji të mira dhe ekzagjeroni çdo gjë.



AKREPI

Përveçse do të jetë një ditë e mërzitshme, sot do të jeni edhe pa financa të mjaftueshme. Do të gjeni zgjidhje gjatë pjesës së dytë të ditës.



SHIGJETARI

Sot po i orientoni të gjitha gjërat në drejtimin që juve ju intereson. Keni një plan të qartë për të ardhmen që doni ta zbatoni sa më shpejt.



BRICJAPI

Dita e sotme do të kalojë duke u marrë me problemet e familjes suaj të vogël. Keni neglizhuar disa gjëra që tashmë janë kthyer në diçka serioze.



UJORI

Sot jeni të gatshëm të shkoni pas kujtdo që do t'ju ftonë në një udhëtim. Ju ka kapur shpirti i aventurës dhe doni të eksploroni vërdallë.



PESHQIT

Është gjithmonë dikush që kujdeset për ju dhe ju këshillon në ato momente që kërkonte mbështetjen e personave të afërm. Kjo ditë do të ketë të reja.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SWEDEN - SWITZERLAND

GG

COLOMBIA - ENGLAND

GG

NOTODDEN - MJONDALEN

GG

Lëshohen vërtetimet e para për sponsoruesit në sport

"MKRS-ja është e përkushtuar ta zbatojë legjislacionin në këtë fushë dhe do ta shqyrtoj me kohë dhe përpikëri çdo kërkesë që paraqitet, në mënyrë që sponsoruesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të përfitojnë nga përfitimet që i ofron Ligji Nr. 05/L-090 për sponsorime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit", ka thënë Kujtim Gashi

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka organizuar të hënën ceremoninë e shpërndarjes së vërtetimeve të parë të sponsorizimit në fushën e sportit. Pas miratimit të akteve normative për sponsorizim ku, sipas tyre, parashihen lehtësime tatimore për ato biznese që sponsorizojnë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, për herë të parë MKRS-ja lëshon vërtetime për klubet sportive. "MKRS-ja është e përkushtuar ta zbatojë legjislacionin në këtë fushë dhe do të shqyrtojë me kohë dhe përpikëri çdo kërkesë që paraqitet, në

mënyrë që sponsoruesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të përfitojnë nga përfitimet që i ofron Ligji Nr. 05/L-090 për sponsorime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit", ka thënë Gashi në takimin me përfituesit e sponsorimeve. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për lëshimin e vërtetimit për sponsorime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ka shqyrtuar kërkesat e para për vërtetim të sponsorimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me ç'rast ka përgatitur pesë vërtetime



në fushën e sportit, të cilat vërtetime sot u janë dhënë përfaqësuesve të klubeve sportive nga ana e ministrit të Sportit, Kujtim Gashi. "Deri më tani Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për lëshimin vërtetimit për sponsorime në fushën e kulturës, rinisë

dhe sportit kanë trajtuar shtatë kërkesa. Kërkesat në fjalë kanë qenë kryesisht nga Departamenti i Sportit dhe një kërkesë nga Departamenti i Rinisë. Nga kërkesat e arritura për shqyrtim, pesë prej tyre i kanë plotësuar kushtet për marrjen e vërtetimit në pajtim me ligjin dhe rregulloren që e rreg-

ullojnë këtë fushë, ndërsa dy janë në fazën e kompletimit të dokumentacionit", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Vërtetimet janë përgatitur në pajtim me Rregulloren e MKRS-së Nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Përfituesit e këtyre vërtetimeve, në prononcimin e përbashkët me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, pas ceremonisë së marrjes së vërtetimeve, u shprehën të kënaqur dhe falënderues, duke e vlerësuar shumë të rëndësishme ndarjen e vërtetimeve për sponsorim. "Është një ditë e madhe për sportin e Kosovës. Kjo ditë shënon fundin e fukarallëkut në sport dhe është një ditë e futjes në një fazë që quhet fazë e stabilitetit financiar në sport", ka thënë Gazmend Hoxha nga Klubi i Volejbollit "Luboteni".

Maliqi largohet pas katër vjetësh nga Feronikeli, përforcon Llapin

Behar Maliqi ka vendosur që pas katër vjetësh t'i japë fund aventurës në skuadrën e Feronikelit nga Drenasi, kurse në edicionin 2018/2019 do të djersijë fanellën e skuadrës së Llapit

EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Mesfushori i dëshmuar në futbollin e Kosovës dhe ish-anëtar i reprezentacionit të Kosovës në futboll, Behar Maliqi, edhe zyrtarisht të dielën në mbrëmje është larguar nga skuadra e Feronikelit. Lajmin për ndarjen pas katër vjetësh me skuadrën nga Drenasi e ka bërë me dije vetë

Maliqi, i cili ka qenë një prej më meritoreve për sukseset e Feronikelit në futbollin vendor. "Nuk do të jem më pjesë e Klubit KF Feronikeli. Në këtë klub kalova katër vjet të mrekullueshëm, me shumë suksese, si në aspektin ekipor, po ashtu edhe në atë personal. Gjatë kësaj periudhe arritëm të shpallemi dy herë kampionë të Kosovës, një herë fitues i Kupës, një herë fitues i Superkupës. Gjithashtu, ishim



në dy finale të Superkupës. Për këto suksese dua ta falënderoj kryesinë e vjetër, e cila ka njerëzuar më profesionistë që kam

punuar në futbollin tonë, për punën profesionale dhe korrektesinë e treguar", ka thënë Maliqi, duke shtuar se: "I falënderoj të gjithë bashkëlojtarët për vitet që kaluam bashkë dhe sukseset që i arritëm. Fituam të gjitha trofetë në futbollin tonë, gjë që tregon se kemi qenë si një familje. Një falënderim shumë të veçantë dua t'u bëj tifozëve 'Tigrat e Zi' dhe qytetarëve të Drenasit për përkrahjen që më dhanë gjatë gjithë kohës - do t'ju jem mirënjohës gjithmonë. Gjithashtu, dua ta falënderoj kryetarin e ri për korrektesinë e treguar dhe ju dëshiroj shumë

suksese". Ndërsa Maliqi nuk ka vonuar shumë për ta gjetur skuadrën e re. Ai ka nënshkruar marrëveshje njëvjeçare me skuadrën e Llapit. "Behar Maliqi, 31 vjeç, lindur më 22. 9. 1986 në Prishtinë, mesfushor, e ka nisur karrierën në klubin Prishtina. Ai ka luajtur edhe për Fushë-Kosovën, KEK-un, Partizanin e Tiranës, së fundmi për Feronikelin, ku kaloi katër edicione të suksesshëm dhe realizoi 22 gola e shumë asistime. Beharit i dëshirojmë mirëseardhje në familjen e madhe të KF Llapit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Llapit.

Kosova përballë Maqedonisë dhe Rumanisë në "Eurobasket 2021"

PRISHTINË, 2 KORRIK - Pas përfundimit të garave në kualifikimet evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019", Përfaqësuesja e Kosovës tashmë do t'i vazhdojë garat në raundin e dytë të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Kosova në këto gara është pjesë e Grupit B në të cilin

bëjnë pjesë edhe Maqedonia dhe Rumania. Ndeshjen e parë Përfaqësuesja jonë do ta luajë më 13 shtator si nikoqire kundër Maqedonisë, kurse më 29 nëntor është mysafire e Rumanisë, pastaj më 2 dhjetor do të luaj si mysafire, kësaj radhe ndaj Maqedonisë, si dhe më 24 shkurt 2019 e pret

Rumaninë në shtëpi. Fituesi i këtij grupi do të kualifikohet në kualifikime për "Eurobasket 2021" që do të fillojnë në nëntor të vitit të ardhshëm, kurse dy kombëtares e tjera e kanë edhe një shans tjetër për t'u kualifikuar, por nëpërmjet një raundi shtesë që do të luhet në gusht të vitit 2019.



Ragip Xhaka: Shqiptarët na kthyen 20 mijë fish gëzimin e shqiptonjës

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ragip Xhaka ka reaguar përmes një letre publike, ku ka sqaruar festën e djalit, Granit Xhakës, me shqiptonjë në ndeshjen ndaj Serbisë. Ai ka shkruar se festa e Granitit nuk ishte provokim politik, por simbol që i identifikon shqiptarët. "Shenja e shqiptonjës është si një tatuazh i gëzimit të shqiptarëve në festa, në dasma, në koncerte, në

ndeshje futbolli dhe nuk ka brenda asnjë urrejtje, madje asnjë lidhje me të tjerët. Është thjesht një shenjë daluese që shqiptarët e njohin menjëherë e nuk kanë nevojë për shpjegime. Prandaj edhe jemi shumë të çuditur me reagimin e atyre që e përjetuan shenjën tonë si ofensivë për ta apo atyre që e trajtuan si gjest politik. Por, nuk jemi aspak të çuditur me sol-

idaritetin e shumë shqiptarëve që janë ndjerë keq nga keqinterpretimet e shenjes dhe kanë marrë pjesë në iniciativën e Edi Ramës për të kontribuar simbolikisht për gjobën e padrejtë që na u vu. I falënderojmë shumë jo për shumën, po për faktin që na kthyen 20 mijë fish gëzimin që u dhamë me shenjën e shqiptonjës pas golave", ka thënë Ragip Xhaka.



Shqiptarët e Zvicrës kërkojnë çerekfinalen

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Katër shqiptarët që e përfaqësojnë Zvicrën, Valon Behrami, Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka dhe Blerim Xhemaili, sot (e martë) kërkojnë kualifikimin në çerekfinale të Kupës së Botës. Kundërshtare e Zvicrës është Suedia, e cila nuk ishte llogaritur favorite për ta kaluar fazën e grupeve, por e bëri një gjë të tillë duke dalë e para në Grupin F, para Meksikës, Koresë së Jugut dhe Gjermanisë. Ndërkohë, Zvicra e nisi mirë këtë kampionat, duke luajtur fillimisht baras me Brazilin (1-1), kurse më pas e mposhti Serbinë me dy golat e shqiptarëve Xhaka-Shaqiri, në fund fitoi edhe ndaj Kosta Rikës. Në ndeshjen ndaj Suedisë që fillon nga ora 16:00, kapiteni i Zvicrës do të jetë Valon Behrami. Ndeshje interesante pritet të jetë edhe përballja në mes të Kolumbisë dhe Anglisë që zhvillohet nga ora 20:00. Kolumbia pësoi një humbje nga Japonia në fazën e grupeve, kurse mposhti Nigerinë dhe Senegalin, ndërsa në anën tjetër anglezët fituan bindshëm ndaj Panamasë (6-1), e mposhti



edhe Tunizinë, derisa në ndeshjen e fundit pësoi humbje nga Belgjika (1-0), me golin e shënuar nga futbollisti shqiptar, Adnan Januzaj.

FORMACIONET E MUNDSHME

Suedia: Olsen; Lustig, Lindelof, Granqvist, Augustinsson; Claesson, Gustav Svensson, Ekdal, Forsberg; Berg, Toivonen.

Zvicra: Sommer; Lang, Schar, Akanji, Rodriguez; Behrami, Xhaka; Xherdan Shaqiri, Xhemaili, Zuber; Gavranović.

Kolumbia: Ospina; Arias, Mina, Sanchez, Mojica; Carlos Sanchez, Uribe, Juan Fernando Quintero, Cuadrado; Muriel, Radamel Falcao.

Anglia: Pickford; Walker, Stones, Maguire; Trippier, Henderson, Alli, Lingard, Young; Sterling, Kane.

Brazili kualifikohet në çerekfinale

MOSKË, 2 KORRIK - Kombëtarja e Brazilit nuk ka lejuar befasi dhe është kualifikuar në çerekfinale të Kupës së Botës. Neymari dhe Firminho i ka dhënë fitoren Brazilit ndaj Meksikës, duke shënuar golat e fitores (2-0). Meksikanët ishin ata që e nisën më mirë ndeshjen, por me kalimin e minutave brazilianët dolën në lojën e tyre duke dominuar mbajtjen e topit dhe duke krijuar mundësitë e para për shënim, por rezultati në fund të pjesës së parë ishte 0-0. Pas pushimit ishte Neymari (51) ai që zhbllkoi rezultatin, por merita ishte e gjitha e Willianit. Mesfushori i Chelsea merr krahun në të majtë, godet topin dhe Neymari e shtyn në rrjetë. Pas golit Brazili mundohet ta kontrollojë lojën dhe nuk vihet asnjëherë në vështirësi nga sulmuesit meksikanë. Përvoja e mbrojtjes është e madhe, ndërsa kundër-



sulmi brazilian i frikshëm. Shumë mundësi për ta siguruar fitoren para kohe, por Neymari me shokë

humbasin shumë raste shënimi. Në fund të takimit ishte Firmino (88) ai që vulosi fitoren për Brazilin.

SHKURT

Berisha prezantohet te Sanfrecce Hiroshima

Besart Berisha është prezantuar tek ekipi i ri Sanfrecce Hiroshima. Japonezët kanë paguar mbi një milion euro për kartonin e sulmuesit nga Kosova. Berisha u shpreh shumë i lumtur me kalimin te ekipi i ri, duke premtuar maksimumin. Hiroshima është lidere e klasifikimit të futbollit japonez.

LeBron James kalon te Los Angeles Lakers

LeBron James është larguar nga skuadra e Cleveland Cavaliersit për t'iu bashkuar Los Angeles Lakersit. James do të jetë pjesë e Lakersave për katër sezona dhe do të përfitojë në total 154 milionë dollarë. LeBron James shihet si shpresë për të ringjallur skuadrën nga Kalifornia, e cila nuk e ka fituar titullin e kampionës që nga viti 2010.

Salahi në Liverpool deri më 2023

Ylli i Egjiptit, Mohamed Salah, ka nënshkruar një kontratë të re afatgjatë me nënkampionen e Evropës, Liverpool. Sulmuesi do të jetë një lojtar i "Reds"-ave deri në vitin 2023, pas "një rritjeje të konsiderueshme page". Rinovimi i Salahit është shpërblim për një person që ka kontribuar shumë për skuadrën dhe klubin. Rinovimi tregon qartë që ai beson te Liverpooli dhe Liverpooli beson tek ai", ka deklaruar trajneri Jurgen Klopp.

Modriq: Gjithë mëngjesin studiova Schmeichelin, sërish më munda

Luka Modriq mund të ishte kthyer në atdhe me barrën e liderit, që dështoi për të tërhequr përpara Kroacinë, e cila ishte treguar përrallore në fazën e grupeve. 11-metërshi i gabuar në minutën e 114-t mund të kishte ndikuar psikologjikisht tek e gjithë skuadra, por në fund ballkanasit dalin fitimtarë, ndonëse fantazisti i Realit të Madridit pranon humbjen e sfidës në distancë me portierin danez Kasper Schmeichel: "Ishte mënyra më e rrezikshme dhe më e vështirë për të kaluar në çerekfinale e turneut dhe jam ende shumë i nervozuar për atë gabim nga pika e penaltisë në kohën shtesë. Kur mendoj se kam qëndruar gjithë mëngjesin përpara ndeshjes duke studiuar se si mund t'i shënoj Schmeichelit dhe pashë që sërish më mposhti, më nervozon. Gjithsesi, e rëndësishme është që në fund arritëm objektivin".

Murray tërhiqet nga Wimbledon

Andy Murray i bashkohet listës së mungesave të mëdha në turneun Wimbledon. Tenisti britanik do të ndeshet në raundin e parë me zviceranin Stan Wawrinka, por vendosi të tërhiqej pasi nuk ndihej në kushtet e duhura fizike. "Kam marrë vendimin të mos jem pjesë e Wimbledonit. Kam bërë shumë progres javët e fundit, por ndiej që nuk jam gati për të luajtur ndeshje që zgjasin pesë sete. Do ta nis stërvitjen për të qenë i gatshëm në US Open", ka shkruar tenisti i famshëm në "Facebook".



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenin 6 pika 5 dhe nenin 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të te Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës, bënë:

Rishpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Ekspert i TI-së
Numri i referencës:	ASK-DSBM-001
Tarifa e shërbimit:	900 Euro (Bruto)
Raportin te:	Udhëheqësi i Divizionit-bartësi i projektit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	5 muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-1

ASK parashikon të vazhdojë pjesëmarrjen e saj në ciklet e raportimit të rregullt për të dhënat statistikore të mbeturinave komunale në Eurostat sipas rregullores së mbeturinave WStatR (EC) No 2150/2002 dhe dërgimin e Raportit të Cilësisë. Qëllimi kryesor i ASK-së është përmirësimi i mëtejme i cilësisë së të dhënave statistikore. Në mënyrë që ASK ti përmbush këto objektiva, shpall konkurs për Ekspert i TI-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon një sistem të bazës së të dhënave dhe një mjet raportimi elektronik për anketën e mbeturinave komunale;
- Zëvendësimi i grumbullimit të të dhënave me pyetësor me letër nëpërmjet transmetimit elektronik të të dhënave;
- I ndihmuar dhe mbikëqyrur nga zyrtari përgjegjës i TI-së së ASK-së, do të zhvillojë një bazë të dhënash për AMK në një server të dedikuar enkas për këtë qëllim. Ky lloj i bazës së të dhënave do të lehtësojë pastrimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave;
- Caktimi i rregullave të validimit dhe redaktimit do të shkruhen në sistem për të marrë të dhëna cilësore nga të anketuarit. Të dhënat do të ruhen në një SQL Server.
- Ndërfaqja do të jetë bazuar në CAWI (Computer Assisted Web Interview), për mbledhjen e të dhënave të AMK
- CAWI do të dizajnohet dhe zhvillohet në një ndërfaqe miqësore që do të jetë e lehtë për të gjithë të anketuarit
- Të gjitha rezultatet e agreguara të anketës AMK do të integrohen në një platformë për shpërndarjen e të dhënave të ASK-së bazuar në modelin PC-Axis dhe SDMX;
- Hartimi i bazës së të dhënave të AMK duhet të jetë i bazuar në modelin dhe konceptin e bazës së të dhënave të dakorduara;
- Bënë dokumentimin e projektit;
- Në mënyrë rigorozë zbaton masat e sigurisë dhe planeve të rikuperimit të të dhënave;
- Në mbikëqyrje të stafit lokal të TI-së, instalon, konfiguron dhe teston ueb aplikacionin në serverin e ASK-së;
- Bashkëpunon me grupet tjera punuese si dhe ndihmon në kontrollimin, krahasimin, analizimin dhe komentimin e të dhënave dhe rezultateve të tyre.

Shkathtësitë e kërkuara:

Diplomë Universitare në fushën e Teknologjisë Informative.

Së paku 4 vjet përvojë punë në fushën përkatëse (e obligueshme).

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e gjuhëve koduese siç: C#, C#Pro, JAVA, IITML, CSS;
- Njohuri të avancuara në teknologjitë ASP .NET, MVC si dhe Microsoft SQL Server;
- Njohuri në standardet e SDMX dhe PC-Axis, përparësi;
- Shkathtësi në planifikim, hulumtim dhe analiza, kapacitet për të kuptuar proceset, për të koordinuar dhe organizuar punët;
- Ruajtja e konfidencialitetit;
- Të jetë i motivuar dhe aftësi për të punuar në atmosferë interdisciplinare;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Afati i konkurrimit : Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendrike nga dita e publikimit në media dhe në web faqen e ASK-së.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhiven e ASK-së, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 - 16: 00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistiki Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova:

Ponovno objavljuje javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije	Agjencia za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	IT Stručnjak
Referentni broj:	ASK-OSPŽS-001
Tarifa usluga:	900 Evra (Bruto)
Izveštava:	Rukovodiocu Divizije- Nosiocu projekata
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge (SPU)
Trajanje ugovora:	5 meseci
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK-1

ASK predviđa da nastavi svoje učešće u redovnim ciklusima izveštavanja o statističkim podacima za komunalni otpad u Eurostat, u skladu sa Uredbom o Otpadu WStatR (EC) Br. 2150/2002 i dostavljanje Izveštaja o Kvalitetu.

Glavni cilj ASK-a je dalje unapređenje kvaliteta statističkih podataka.

Da bi ispunila ove ciljeve, ASK raspisuje konkurs za IT Stručnjaka.

Zadaci i odgovornosti:

- Razvoj sistema za baze podataka i alata za elektronsko izveštavanje za Anketu Komunalnog Otpada;
- Zamena prikupljanja podataka upitnikom u formi papira putem elektronskog prenosa podataka;
- Uz pomoć i pod nadzorom odgovornog IT službenika ASK-a, će razviti bazu podataka za AKO na posebnom serveru specijalno za tu svrhu. Ova vrsta baze podataka će olakšati čišćenje, obradu i analizu podataka;
- Postavljanje pravila validacije i uređivanja biće napisana u sistemu kako bi se dobili kvalitativni podaci od ispitanika. Podaci će biti sačuvani na SQL Serveru.
- Interfejs (sučelje) će biti zasnovan na CAWI (Computer Assisted Web Interview), za prikupljanje podataka AKO-a.
- CAWI će biti dizajniran i razvijen u interfejsu prilagođen korisnicima koji će biti lak za sve ispitanike;
- Svi agregirani rezultati AKO-a biće integrisani u platformu za discriminaciju podataka ASK-a, na osnovu modela PC-Axis i SDMX.
- Izrada baze podataka AKO-a treba da se zasniva na modelu i konceptu dogovorene baze podataka.
- **Veštine u oblasti dokumentacije projekata**
- Striktno sprovodi mere bezbednosti i planove spašavanja (povratka) podataka;
- Pod nadzorom lokalnog IT osoblja, instalira, konfigurise i testira web aplikaciju na serveru ASK-a;
- Saradjuje sa drugim radnim grupama i pomaže u kontroli, upoređivanju, analiziranju i interpretaciju podataka i njihovih rezultata.

Tražene sposobnosti:

- Univerzitetaska diploma iz oblasti Informativnih Tehnologija.
- Najmanje 4 godine radnog iskustva u relevantnoj oblasti (obavezno).

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje programskih jezika kodiranja, kao što su C #, C#Pro, Java, HTML, CSS;
- Napredno poznavanje ASP, NET, MVC tehnologije, kao i Microsoft SQL Server;
- Poznavanje standarda SDMX i PC-Axis, prednost;
- Veštine u planiranju, istraživanju i analiziranju, sposobnost da razume procese, da koordinira i organizuje rad;
- Očuvanje povjerljivosti;
- Motivisan i sposoban za rad u interdisciplinarnoj atmosferi;

Agjencia za Statistiku Kosova dočekuje aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica..

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svih punoletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Rok za prijavljivanje: Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja na media i internet stranici ASK-a.

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz aplikacije potrebno je priložiti: Kopiju lične karte, kopije dokumenata okvalifikaciji i drugu potrebnu dokumentaciju koja se traži u konkursu. Nepotpune aplikacije i podnete nakon isteka roka neće biti prihvaćene. Zbog velikog broja primljenih aplikacija, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani. Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038-200 31149 od 08:00 - 16: 00 časova.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

SHPALLJA E REKRUTIMIT

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë
Departamenti: Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Titulli i vendit të punës: Asistent Administrativ
Kategoria funksionale/Grada: Koeficienti - 6
Afati i kontratës: Nëpunës i karrierës – me kohë të pa caktuar
Nr. i Referencës: MSh-019/06/2018

Detyrat kryesore:

1. Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike, përfshirë postën zyrtare, telefonat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e rapoteve të shpenzimeve, si dha hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
2. Përgatit dhe modifikon dokumentet, duke përfshirë korrespondencën, raportet, momerandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin;
3. Pranon dhe shpërmdan korrespondencën për mbikëqyrësin, dhe kujdeset për mbarëvajtjen e sajë;
4. Ruan dhe mirëmbanë sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit;
5. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin, si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problem administrativ dhe teknik;
6. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

